

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7813 E enjte 7 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

## Opinion i Ditës

**R**rethimi me tela me gjemba i zonës së Kuvendit, edhe pse pamje e rëndë për kamerat e televizioneve të huaja, dha mesazhin e qartë se do të ishte mision tejet ...  
Vijon në faqen 20

Nga FATOS ÇOÇOLI

Telat me gjemba dhe dhuna e trembur



## Opinion i Ditës

**E**di Rama e braktisi me shpejtësi parlamentin të martën paradite duke njoftuar se do të udhëtonte drejt Italisë për të përmirësuar, tek fqinjët, imazhin që ...  
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI

Pse Edi Rama nxitoi drejt RAI-t



Kreu i PD: S'ka marrëveshje të dytë  
**Basha: S'ka hapa pas, zgjedhje para kohe. Rama në Itali: TV rus dhe "direkt" protestat**

Kryeministri, katër intervista për 24 orë në mediat italiane. Gafa, Tavo ende deputet

Nga VALENTINA MADANI

Partia Demokratike po përgatitet për zgjedhje parlamentare duke filluar me organizimin e zgjedhjeve primare në parti nën shembullin e modelit amerikan. Ky hap i demokracisë do të jetë njëherësh me protestat nga të cilat Lulzim Bashën ...  
Në faqen 2-3

## LISTA/ 6 MIJE FAMILJET QE IU NJIHET E DREJTA PER TE MARRE PARATE

# DOSJET QE NGA 1993, EMRAT E PRONAREVE QE KOMPENSOHEN

Publikohen në Fletoren Zyrtare përfituesit në të gjithë vendin. Aplikimet në 20 vite deri më 2013, Agjencia e Pronave: Si do të ndahet fondi financiar



(Në foto) Toka në bregdet

Në faqen 14-17

### "PERGJIMI I XHAFAJT"

**Prokuroria merr të pandehur, Ervin Saliqin. PD: S'na e mbyllni dot gojën**

Në faqen 6

### MISTERI

**Raportoi për TV rus, gazetari: Jam shtatzënë, më dëbuan nga Tirana**

Në faqen 2

### DEMSPERBLIMI

**Të përndjekurit, emrat dhe mungesa e dokumenteve në dosjet e secilit**

Në faqen 10-11

### VENDIMI I GJYQIT

**Trafikuan 2.5 tonë hashash në Itali, 36 vite burg për 6 anëtarët e grupit**

Në faqen 7

### KREU I DHOMES SE TREGTISE



**Landfilli në Sharrë, Nikolin Jaka: Tarifat abuzive po na falimentojnë**

Në faqen 5

Ambasadori austriak prezanton para studentëve projektet: Afat deri më 29 mars

## Sattler te "Luarasi": Si të përfitoni bursa në Austri

Rektori Ethem Ruka vlerëson marrëdhëniet mes dy vendeve: Të forta e solide

NGA VOLTIZA DURO

Shkëmbimi i eksperiencave dhe ofrimi i bursave në vende të ndryshme të botës, është përparësi për studentët që synojnë një karrierë të suksesshme në të ardhmen. Në kuadër të projekteve të mobilitetit,



ambasadori austriak në Shqipëri, Johan Sattler, ishte i pranishëm në universitetin "Luarasi". Ai prezantoi para studentëve procedurën e aplikimit për bursa në shkollën verore në Alpbach të Austrisë dhe iu bëri thirrje që të përfitojnë nga ...  
Në faqen 8

## KRIZA POLITIKE PROTESTAT

Kryeministri Edi Rama katër intervista brenda 24 orëve për mediat italiane

# Rama hedh dyshime: Pas protestave të opozitës mund të qëndrojë Rusia

"Opozita nuk ka shanse të fitojë në zgjedhjet lokale"

Kryeministri Edi Rama ka ndërmarrë një inkursion të gjerë mediak për të përmirësuar imazhin e Shqipërisë në sytë e të huajve që sipas tij është dëmtuar nga protestat e opozitës dhe aktet sporadike të dhunës të ndodhura në to. Brenda 24 orëve të fundit ai zhvilloi katër intervista të ndryshme në mediat kryesore italiane si "Rai 1", "La Repubblica", "TG5" apo la "La 7", ku mes të tjerave foli për situatën politike në Shqipëri, ndërsa u përpoq të theksojë se në Shqipëri nuk ka asnjë anomali që mund të sjellë cenimin e sigurisë qytetarëve të saj dhe atyre të huaj, përfshi edhe italianët që janë në një numër të konsiderueshëm. Duke u ndalur gjatë te protestat ai theksoi se ato nuk janë të qytetarëve, por të disa forcave politike, të cilat sipas tij kërkohet pushtetin në tavolinë pasi nuk janë të gatshme për ta fituar atë me zgjedhje. "Protestat e këtyre ditëve nuk janë reagim i njerëzve, por sulme të lidhura me një grup pushtetarësh të dëbuar prej më shumë se pesë vjet më parë. Ajo që dëshiron opozita është e vështirë të shpjegohet. Opozita nuk ka shanse të fitojë në zgjedhjet lokale në qershor: lidhshipi do të donte të shmangte përgjegjësinë për humbjen", - tha Rama gjatë një interviste për "La Repubblica". Gjithashtu, Rama hodhi poshtë akuzat dhe pretendimet e opozitës se mazhoranca aktuale nuk është legjitime pasi ka vjedhur votat e shqiptarëve. Rama edhe një herë siguroi gazetarin italian se shumica aktuale qeverisëse i ofroi opozitës para zgjedhjeve parlamentare të gjitha garancitë ligjore dhe institucionale për ta organizuar dhe monitoruar ajo procesin zgjedhor: "Ne fituam zgjedhjet me një shumicë absolute, pasi u treguam të hapur ndaj opozitës duke i dhënë asaj përgjegjësinë e disa ministrive për periudhën e zgjedhjeve, përfshirë edhe drejtimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pavarësisht mazhorancës që kishim. Marrëveshja ishte që në fund fituesit do të qeverisnin dhe humbësit do të shkonin në opozitë pa e bërë Shqipërinë subjekt të propagandës së brendshme politike në medianë ndërkombëtare. Në vend të kësaj, protestat filluan menjëherë, por qeveria është e fortë, sondazhet e kanë konfirmuar këtë", - shtoi më tej Rama. Gjithashtu, kryeministri Rama hodhi dyshime se pas protestave të opozitës dhe vendimit të saj për të djegur



Kryeministri Edi Rama, dje gjatë intervistës për "TG5"

### RAMA: KËRKESAT E OPOZITËS, SI T' I THUASH JUVENTUSIT LUAJ PË RONALDON

Gjatë intervistës për "Rai 1" kreu i qeverisë ka bërë edhe krahasim mes kërkesës së opozitës për një qeveri tranzitore pa Ramën kryeministër dhe një kërkesë absurde që mund të ndodhte në kampionatin italian ku të kërkohet që Juventus të luante pa Ronaldon. "Ata kanë braktisur parlamentin dhe thanë që nuk hyjnë në këtë parlament, kryeministri duhet të largohet, një tjetër qeveri që ka pëlqimin tonë duhet të krijohet. Pra, "Juventus" duhet të largohet.", -tha Rama.



Protesta e opozitës para kuvendit

## Ë sulmoi OMONIA, reagon Ligoraq Karamelo: Vendimi i konsultuar

Organizata minoritare OMONIA ka reaguar dhe lidhur me vendimin e anëtarit të saj, Ligoraq Karamelo për të marrë mandatin e deputetit. Ajo e konsideron atë një vendim krejtësisht individual të Ligoraq Karamelos, të cilin ajo e thërret në greqisht Grigor dhe të pa konsultuar me organizatën. "Me qëllim shmangjen e çfarëdo përshtetësi të padëshiruar në referencë të zgjedhjes personale dhe vendimit individual të anëtarit tonë të zgjedhur në forumet drejtuese të organizatës, z. Grigor Karamelo, për të pranuar pozicionin e depu-



titit të listës së Partisë Demokratike, sqarojmë se për këtë nuk pati dhe nuk ka asnjë dakordësi miratuese nga ana e organeve institucionale të OMONIA-s", - thuhet në reagimin e OMO-

NIA-s. Ndërsa vetë Karamelo duke folur për "Gazeta Shqiptare", hedh poshtë këto pretendime duke se vendimi ishte i konsultuar me OMONIAN dhe PBDNJ-në e Korçës. "U njoha me deklaratën e "porositor" të nxjerrë në emër të OMONIA-s. Nuk dua të bëj asnjë koment, veç t'u ritheksoj se "vendimi që mora është vendim kolegjial i strukturave të OMONIA-s e PBDNJ të garkut të Korçës dhe nuk është vështirë të verifikojmë mendimin e tyre. Diçka po theksoj, mos e fusni minoritetin etnik grek në vorbullën e partive të mëdha", - tha Karamelo.

pushtetarësh", u shpreh ai për "La Repubblica". Edhe gjatë intervistës në emisionin "Porta e porta" të gazetarit të njohur italian, Bruno Vespa, Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama deklaroi se në Shqipëri nuk po ndodh asnjë revoltë popullore, se në vend ka stabilitet për biznesin e huaj dhe se numri i turistëve është gjithnjë në rritje.

mandatit qëndron Rusia. Për këtë ai u referuar edhe faktit që protesta e opozitës herë të parë u transmetua live nga televizioni shtetëror rus. "Ne nuk kemi fakte konkrete, por shumë të dhëna: Televizioni rus ka transmetuar drejtpërdrejt protestat, por nuk ka asgjë për t'u befusuar. Moskë ndjek interesat e saj dhe Shqipëria brenda Bashkimit

European nuk ndodhet në mesin e tyre", - deklaroi Rama. Nga ana tjetër ai theksoi se fakti që mazhoranca përball me një opozitë të dobët, rrezikon ta kthejë atë në një grup pushtetarësh. "Shumicë e forta që nuk nxiten nga opozita në fushën e ideve, rrezikojnë të vetëpengohen. Rrezikojnë të transformohen nga një qeveri në një grup

### SHKURTE

#### Misteri, raportoi për TV rus, gazetarja: Shtatzënë, më dëbuan nga Tirana

Alice Taylor, gazetarja angleze që u bë e njohur në vendin tonë me një shkrim ku rendiste 28 veset e shqiptarëve, duket se nuk do të ketë më mundësi të qëndrojë në Shqipëri. Vetë Taylor përmes një postimi në Twitter shkruan se autoritetet shqiptare i refuzuan shtyrjen e lejes së qëndrimit, pavarësisht se është në muajin e 6-të të shtatzënisë dhe pret një fëmijë nga i fejuari i saj shqiptar. Kujtojmë që Taylor ka raportuar edhe për televizionin rus "Russia Today" në lidhje me situatën politike të krijuar në vend dhe thotë se pikërisht raportimet kritike për situatën politike kanë sjellë edhe këtë vendim të autoriteteve shqiptare. "Qeveria shqiptare, pasi më ka sulmuar mua dhe partnerin tim për shkak të punës sime si gazetar dhe kritikave të mia ndaj tyre, tani ka anuluar rrovimin e lejes sime të qëndrimit. Pra, jam këtu në mënyrë të paligjshme dhe më kërkohet që të largohem, pavarësisht se kam një certifikatë mjekësore ku thuhet se nuk mund të udhëtoj për shkak të komplikimeve që mund të më dalin nga të qenit gati 6 muaj shtatzënë. Pres një fëmijë shqiptar", - shkruan Taylor.

#### Gjylameti: Prisja që disa deputetë t'i thoshin jo djegies së mandateve

Për deputeten socialiste Blerina Gjylameti protestat e opozitës dhe djegia e mandateve të deputetëve të saj kanë vetëm një qëllim, marrjen e pushtetit në tavolinë. Duke folur në "News24" në rubrikën "Opinion" ajo tha se opozita kërkoi një zgjidhje që cenon parimet demokratike dhe Kushtetutën e vendit. "Sot kërkohet të ndahet pushteti në tavolinë. Të shkelim demokracinë dhe funksionimin e parlamentit pasi nuk mund të vijmë në pushtet me votë", - u shpreh ajo. E pyetur nëse ajo çfarë po ndodh përbën edhe një shqetësim për qytetarët, Gjylameti u shpreh se është me shumë rreth parlamentit dhe se mazhoranca do vazhdojë angazhimin e saj. "Mendoj se e gjithë situata që ndodh është përreth parlamentit. Nuk e shoh në të gjithë Shqipërinë", - tha Gjylameti. Përveç kësaj, ajo u shpreh e zhgënjyer nga disa kolegë të opozitës që mund t'i kishin thënë "jo" vendimeve të marra. "Prisja shumë që disa kolegë të opozitës të dilnin jashtë rreshtit për t'i thënë jo një politike që sjell vetëm kaos. Për ne si PS, angazhimi ynë është që duhet të vazhdojmë mandatin legjitim për të qeverisur vendin deri në 2021. Ne jemi të hapur për dialogun. Përballja duhet të jetë në tempullin e demokracisë", - tha Gjylameti.

REDAKSIONI: Redaktor i Suplementeve dhe Sociales: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Ltaqa Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0680807823 e-mail: marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës

së Autotrafektorëve, Tiranë - Tel: (04) 2359-104 Tel&Fax: (04) 2359-116 Marketingu: Tel: (04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik" Shpk



#### AMBASADA

Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë përmes deklaratave të saj ka dënuar dhunën e ndodhur gjatë protestave të opozitës duke i bërë thirrje udhëheqësve politikë shqiptarë për të siguruar tubime paqësore.

#### "PS shpenzon 2.2 mln euro për oligarkët"

**PD: Qeveria po grabit pronarët, 3 herë më pak kompensim**

Partia Demokratike akuzoi dje qeverinë se po grabit pronat e pronarëve të ligjshëm. Ish-deputetja Jorida Tabaku duke iu referuar vlerësimit të bërë nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, tha se shteti ka vendosur të ulë vlerën e kompensimit dhe kthimit të pasurive të pronarëve me 3 herë. "Skema në kurriz të pronarëve është si vijon: nga vlera prej 4.9 mld euro, qeveria fillimisht ka vlerësuar të japë 600 mln euro, por kjo vlerë u zvogëluua deri në 3 herë me VKM në 2017 e në vijim. Qartazi kjo mazhorancë dhe qeveri ka vullnetin politik për të shpenzuar 2.2 miliardë euro për qokat koncesionare, për tenderë për oligarkët, për shpenzime luksi, por nuk ka vullnet politik për të kompensuar siç duhet pronarët e tokës", theksoi zj.Tabaku. Sipas saj grabitja e pronës nga mazhoranca po bëhet përmes ligjit për kthimin dhe kompensimin, ligji për investimet strategjike, atë të kadashtës dhe dy VKM-të e qeverisë që sipas selisë blu i japin autoritet ekzekutiv të mos ia japë pronën pronarëve.

#### Ademi: Edhe kryebashkiakët drejt djegies së mandateve

Voltana Ademi deklaroi dje se po diskutohet mundësi e djegies së mandateve edhe nga kryebashkiakët e opozitës. Kryebashkiakja e Shkodrës tha për "Ora News" se do mbështesë çdo vendim të Partisë Demokratike. "Është një proces në diskutim, por si anëtare e PD-së do mbështes çdo vendim. Opozita mori vendimin ekstrem të djegies së mandateve pasi nuk kishte zgjidhje tjetër. Vendimi u mor në një situatë të rëndë ekonomike dhe politike, ndaj njerëzit kanë dalë në shesh. Kryeministri e njëj Shkodrën mirë ndaj edhe i trembet. Shkodranët janë njerëz të lirë, nuk marrin urdhra nga ne", deklaroi z.Ademi.

Protestat anti-Rama, zv/ambasadorja amerikane takon Bashën e Kryemadhin

# Basha përjashton dialogun me Ramën: S'ka marrëveshje të dytë

Si modeli amerikan, PD gati për zgjedhje parlamentare

Valentina Madani

Partia Demokratike po përgatitet për zgjedhje parlamentare duke filluar me organizimin e zgjedhjeve primare në parti nën shembullin e modelit amerikan. Ky hap i demokracisë do të jetë njëherësh me protestat nga të cilat Lulzim Bashën s'e bindi dje që të heqë dorë as biseda një orë me zëvendësambasadoren e SHBA-ve në Tiranë Lejla Moses-Ones. Pas takimit në zyrën e tij, Basha u tregua hermetik lidhur me temën e takimit që pati me zv/ambasadoren amerikane, por ripërsëriti qëndrimin se nuk do të ketë dialog me kryeministrin Rama. Kreu demokrat zgjidhjen e krizës politike e sheh pa një dialog mes tij dhe shefit të qeverisë. "Nuk komentoj as deklaratat dhe as bisedat përfshirë edhe atë të SHBA. Po të më pyesni për qëndrimin tim, s'ka hapa pas. Dialogu midis meje dhe z.Rama provoi të ishte i dëmshëm për interesat e Shqipërisë në mënyrën si u keqpërdor nga një njeri që hiqet si kryetari i PS-së, por është reduktuar në një bashkëpunëtor të kimit të organizuar dhe të oligarkëve grabitqarë që dëmtojnë interesat e shqiptarëve, -tha z.Basha.



Kreu i opozitës Lulzim Basha me zëvendësambasadoren e SHBA-ve në Tiranë Lejla Moses-Ones

#### DEKLARATA

"Dialogu mes meje dhe zotit Rama provon të ishte i dëmshëm për interesat e Shqipërisë në mënyrën si u keqpërdor nga një njeri që hiqet si kryetari i PS por është reduktuar në një bashkëpunëtor të kimit të organizuar dhe të oligarkëve grabitqarë që dëmtojnë interesat e shqiptarëve", -tha z.Basha.

#### "Zgjedhja, amendamentet e PS janë të njëanshme"

**Bylykbashi: Rama duhet përzënë, ka 20 vite që bashkëpunon me bandat**

Ish-deputeti i PD-së, Oerd Bylykbashi akuzon kryeministrin Edi Rama se ka 20 vite që bashkëpunon me bandat ndaj duhet larguar nga pushteti. Sipas tij është në interesin publik, largimi i Ramës nga qeveria. Bylykbashi u shpreh në "News 24" se Rama ka 20 vite në pushtet dhe në kohën që drejtohte Bashkinë e Tiranës bashkëpunonte me bandat. "Askush nuk voton një qeveri kriminale. Ata që njohin historikun në pushtet të z.Rama, që hiqet si i ri në politikë, ka 20 vite në pushtet. Kush e njeh që në kohë e Bashkisë së Tiranës, e di që e ka menaxhuar pushtetin së bashku me bandat. Për rrjedhojë është në interes publik për



ta përzënë edhe nga qeveria. Ja ku e kemi sot PS-në, e cila është e uzurpuar totalisht dhe është në një kapje totale të shtetit. Ajo që është më e rëndë është se Rama kontrollon çdo pushtet. Mbi të gjitha kjo krizë e rëndë shogjore, shumëplanëshe, rikompozohet vetëm në një gjë,

me zgjedhje të parakohshme", tha ai. Sipas Bylykbashit është e vështirë të mbahet një qeveri që i ka humbur legjitimitetin. "Sigurisht që mund të rrezohet. Por problemi është kush mund ta mbajë një qeveri që i ka humbur legjitimitetin. Askush nuk mund të mendonte se një institucion si Kuvendi mund të qëndronte pa opozitë. Që ta bëjmë të qartë, mazhoranca ka bërë dy veprime që e minuan reformën zgjedhore. Mbjaj mend që në 2016, mazhoranca me kryetarin Taulant Ballën, e bllokuan. Kodi Zgjedhor u bë në mënyrë të njëanshme nga PS, uroj shumë që nuk ua ka marrë mend shejtani dhe të ecin përpara në këtë rrugë"-tha z.Bylykbashi.

rrugë drejtësisë", deklaroi ai. Lulzim Basha siguroi se: "nuk ka asnjë hap pas në luftën kundër kimit të organizuar që ka asgjësuar zgjedhjet dhe institucionet demokratike. Ka vetëm hapa përpara, këtë ia kemi borxh Shqipërisë dhe ëndërrës së gjithë shqiptarëve. Ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europa, me parlament dhe qeveri të çliruar nga krimi, me institucione që u shërbejnë qytetarëve dhe japin llogari para tyre dhe jo para Niçes, Bajrëve, Shullazëve apo or-

takëve të tjerë të bandës aktuale që i thotë vetes qeveri". Teksa kryeministri Edi Rama nga "Porta a Porta" e quajti mikun im, Basha vuri në dukje se populli ka folur dhe kryeministri është shkaktar i kësaj krize të shumfishtë në vend. "Populli ka folur edhe dje, (e martë) do të flasë çdo protestë, do të flasë dhe me 16 mars. Edi Rama bën mirë të dëgjojë zërin e popullit dhe t'i hapë rrugë zgjidhje politike. Ti zgjidhë duart drejtësisë dhe të lejojë hetimin deri në fund të dosjes

"339" dhe dosjes "184". Natyrisht e di se nuk është në gjendje ta bëjë këtë sepse është pjesë e kësaj dosje. Ndaj zgjidhja kur të gjitha pushtetet janë të kapura mbetet në dorë të popullit. Populli do të vazhdojë të ketë në dorë fatin e tij derisa të kemi klimin e Shqipërisë nga krimi, një parlament dhe qeveri të zgjedhur nga populli dhe jo nga kriminelët", u shpreh z.Basha. Zv/ambasadorja amerikane takoi dje në selinë e LSI-së edhe Monika Kryemadhin.

# NDERKOMBETARET REAGIMET

Presidenti i PPE: Rruga e Shqipërisë në BE kalon përmes demokracisë funksionale

## Kriza, zyrtari i lartë i BE sot në Tiranë, takon Ramën e Bashën

### Arvizu: Parlamenti është legjitim!

Valentina Madani

Kriza politike në vend ka vënë në lëvizje faktorin ndërkombëtar duke intensifikuar përpjekjet për zgjidhjen mes palëve. Pas delegacionit të Parlamentit Evropian, Drejtori i Përgjithshëm për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negocimit e Zgjerimit, Christian Danielsson do të zhvillojë sot një vizitë një ditore në Tiranë. Vizita e zyrtarit të lartë të BE-së ishte programuar më parë, por tashmë duket se axhenda e tij ka ndryshuar për shkak të krizës politike në vend, situatë e cila mendohet të marrë edhe të gjithë fokusin e diskutimeve. Gjatë qëndrimit në Tiranë Christian Danielsson, do të ketë takime me kryeministrin Edi Rama në orën 09:30 dhe në 10:30 do të takojë kreun e PD-së Lulzim Basha. Në përfundim të takimeve, Danielsson do të mbajë një konferencë për mediat në 12:00. Vizita e Danielsson në Tiranë vjen në një moment krize politike dhe situatë të paqartë me opozitën që la mandatet parlamentare dhe vijon protestat në rrugë kundër qeverisë, ndërsa një pjesë e kandidatëve në listat e opozitës po pranojnë mandatet e deputeteve. Kjo situatë ka shqetësuar edhe ndërkombëtarët, të cilët kanë paralajmëruar se kjo lëvizje e opozitës dhe protestat herë pas herë me dhunë rrezikojnë të pengojnë procesin e integritetit dhe në mënyrë të veçantë të hapjes së negociatave të Shqipërisë që ishte menduar se do të ndodhte në qershor.

#### MBËSHTRITJA

Presidenti i PPE, Joseph Daul, konfirmoi dje se PPE po e ndjek me shumë vëmendje dhe prioritet situatën në Shqipëri, teksa shprehu vendosmërinë e tij për ta ndihmuar vendin tonë në rrugëtimin evropian. Z. Daul theksoi se ky rrugëtim kalon përmes parimeve themelore të shtetit të së drejtës dhe demokracisë funksionale. Pikërisht këtë qëndrim z.Daul ia bëri



Drejtori i Përgjithshëm për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negocimit e Zgjerimit, Christian Danielsson

të ditur kreut të FRPD-së Belind Këlliçi gjatë vizitës së tij në Bruksel. Mes tyre u diskutua gjerësisht mbi zhvillimet në Shqipëri dhe përpjekjet që po bëhen opozita për mbrojtjen e vlerave demokratike dhe themelit të kë-

tyre vlerave, votës së lirë. Belind Këlliçi vuri në dukje se vota e lirë është sot peng i kërimit dhe shqiptarët janë ngritur për t'i dhënë fund kësaj situatë. Gjatë qëndrimit në Bruksel, Kryetari i FRPD mori pjesë në konfer-

#### AXHENDA

Pas delegacionit të PE, Drejtori i Përgjithshëm për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negocimit e Zgjerimit, Christian Danielsson do të zhvillojë sot një vizitë një ditore në Tiranë. Danielsson, do të ketë takime me kryeministrin Rama në orën 09:30 dhe në 10:30 do të takojë kreun e PD-së Basha. Në përfundim të takimeve, Danielsson do të mbajë një konferencë për mediat në 12:00.

encën e organizuar nga Grupi i PPE-së në Parlamentin Evropian me temë: "Promovimi i procesit të pajtimit në Ballkanin Perëndimor: perspektiva e të rinjve". Kreu i të rinjve demokratë shqiptarë u bëri thirrje drejtuesve të Bashkimit Evropian të shtojnë vëmendjen ndaj rajonit të Ballkanit, ku shkelja e vlerave themelore të demokracisë në disa



Presidenti i PPE, Joseph Daul dhe kreu i FRPD-së, Belind Këlliçi

vende po sjell destabilitet. "BE duhet të rrisë përpjekjet e saj në mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave themelore në vendet tona, si demokracia funksionale, liria dhe të drejta të tjera me rëndësi vendimtare." - tha Këlliçi, i cili vlerësoi si kyç për Ballkanin, bashkëpunimin rajonal.

#### DEKLARATA

Alexander Arvizu, ish-ambasadori i SHBA në Tiranë, në një intervistë me Skype nga Uashingtoni për Top Channel, Muhamed Veliu, i pyetur për zhvillimet politike në vend deklaroi se aktualisht shumë shqiptarë ndihen të depresionuar dhe të sflitur. "E di që opozita ndihet shumë e frustruar", thotë Arvizu, i cili thekson se "po të ngrihen pyetje mbi legjitimitetin e zgjedhjeve të 2017, tanimë në 2019, logjika

nuk qëndron, nuk bën shumë sens", deklaroi Arvizu. Unë besoj, shtoi ai se qeveria e mori pushtetin këtë mandat ashtu siç edhe ndodhi me mandatin e shkuar, në mënyrë shumë legjitime. I pyetur për kërkesën e opozitës për një qeveri tranzitore, Arvizu shprehet se "në këtë rast, mua nuk më duket si një veprim i menduar mirë" shprehet ai. "Në një moment të caktuar Perëndimi kishte besim tek Z. Basha", deklaroi Arvizu, i cili më tej shpreh mendimin se një pjesë të mirë të këtij besimi e ka humbur. "Mendoj se qeveria Rama mund të bënte më shumë në aspektin e të dëgjuarit të popullit", thotë Arvizu, sipas të cilit qeverisja e Ramës ka pasur zhvillime pozitive, por ka pasur edhe zhgënjime, siç është rasti i skandalit me Unazën e Re.

## Vendimi i ministrisë, pakicat kombëtare do mësojnë në gjuhën e tyre

Personat që i përkasin një pakice kombëtare, do të arsimohen në gjuhën e tyre të origjinës në institucione arsimore publike shqiptare. Në zbatim edhe të detyrimeve të ligjit, por edhe të konventave ndërkombëtare, qeveria shqiptare ka hartuar një projektvendim, i cili përcakton se në institucionet arsimore ekzistuese, ku gjuha e arsimimit është gjuha shqipe, nxënësit e një pakice kombëtare kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare që i përkasin, si dhe të studiojnë historinë, traditat dhe kulturën e tyre, sipas kurrikulave dhe programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Që një pakicë kombëtare të përfitojë nga ky vendim duhet që numri i anëtarëve të saj të jetë jo më pak se 20 për qind e numrit të përgjithshëm të banorëve të njësisë administrative, konfirmuar kjo me vërtetim të lëshuar sipas të dhënave nga Regjistri Themelitarë të Gjendjes Civile dhe /ose Regjistri Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010. Gjithashtu, ky vendim përcakton se numri i nxënësve që u përkasin pakicave kombëtare që kanë të drejtën të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare që i përkasin, si dhe të studiojnë historinë, traditat dhe kulturën e tyre, duhet të jetë jo më pak se 15 nxënës për klasë në bazë të kërkesës formale nga prindërit apo kujdestarët ligjorë.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Sigurimi i koleksioneve të muzeut të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,515,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Sigurimi i koleksioneve të muzeut të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 28 Mars 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Biznesit të ndërtimit i faturojnë shtesë edhe një tarifë prej 480 lek/ton për dherat

# Abuzimi në landfillin e Sharrës, Jaka: Tarifat po na falimentojnë

## Bizneset kërkojnë implementim të ligjit sipas standareve të BE

S sektori i ndërtimit po shkon drejt kolapsit për shkak të barrës së taksave që rëndojnë mbi të. Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Nikolin Jaka shpreh shqetësimin se përcaktimi i taksave që shtohen çdo vit, biznesit të ndërtimit i faturojnë shtesë edhe një tarifë prej 480 lek/ton për dherat që shkarkojnë në landfillin e Sharrës. Një tarifë e tillë sipas Nikolin Jakës është e padrejtë, e palogjikshme dhe e cënon këtë sektor. "Industria e ndërtimit është industria më e rënduar me taksat dhe tarifa të palogjikshme në ushtrimin e aktivitetit të vetë. Me atë që po shikoj është se ka një tendencë për ta mbyllur këtë industri sepse 8%, 3%, 1% dhe tarifa e dheut e bëjnë të pamundur të kesh iniciativë në këtë industri sepse në shumicën e rasteve ose kthehen në kolateral për kompanitë që investojnë në sektorin e ndërtimit ose në proces falimentimi në disa raste të tjera që janë të pamenduara nga sipërmarrësit. Por kjo tendencë e përgjithshme e hapur që në ndërtim fitohet dhe kanë mbingarkuar në mënyrë të padrejtë këtë sektor unë besoj se shumë shpejt do shkohet në një kolpas që do kthehet në boomerang për të gjithë sipërmarrësit në rradhë të parë por jam i bindur edhe për buxhetin dhe institucionet që bashkëpunojnë me sektorin e ndërtimit." -thekson Jaka.

### KËRKESA

Bizneset e ndërtimit në kryeqytet janë në një komunikim të vazhdueshëm me ministrin të Përgjegjës dhe Bashkinë e Tiranës për të gjetur një zgjidhje sa më të shpejtë përpara se të përfundohen të dhërat. "Jemi në fazën e komunikimit dhe të paratës së ankesave tona pranë Ministrisë së Financave dhe Bashkisë së Tiranës në mënyrë që të gjejmë një zgjidhje të paktën për ndarjen e dherave dhe mbetjeve të pakontaminuara dhe mbetjeve dhe inertet dhe mbetjeve të tjera të kontaminuara." - deklaroi



Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Nikolin Jaka

### TARIFA PËR KONCENSIONARIN

Prej disa ditësh kompani të ndërtimit dhe shoqata të biznesit po denoncojnë një tarifë që prej mëse 7 muajsh i paguajnë koncesionarit për të depozituar në landfill dherat e pakontaminuar. Ky vendim i pashkruar sipas ndërtuesve nuk bazohet në direktivën e Bashkimit Europian sipas së cilës, dherat e gërmuara gjatë aktiviteteve ndërtimore janë të pakontaminuara dhe si të tilla nuk duhet të cilësohen inerte, por një mall që mund të përdoret edhe për veprimtari të tjera.

Jaka. Tarifa prej 480 lek/ton mbi dherat e pakontaminuara që paguhet në Sharrë nga ndërtuesit për llogaritë të kompanisë "Integrated Energy" B.V me miratimin e Bashkisë së Tiranës dhe Ministrisë së Mjedisit, sipas Jakës është rasti i vetëm që ndodh në Shqipëri. Në emër të ndërtuesve Jaka kërkon nga shteti respektimin e ligjit dhe të direktivës së Bashkimit Europian. "Nga analiza që kemi bërë tek shoqata e ndërtuesve është një analizë që është rasti i parë në Shqipëri që dherat të pakontaminuara duhet

të trajtohen në këtë kontratë të tillë ndërkohë që ne jemi dakort të ketë për një kontratë bashkëpunimi apo të hedhjes së mbetjeve inerte gjithmonë kur kemi të bëjmë me mbetje të kontaminuara sic e përcakton legjislacioni i BE. Ne nuk kërkojmë asgjë tjetër vetëm të ketë një implementim të ligjit ashtu sic janë edhe ligjet e BE që shoqata e ndërtuesve ka bërë një analizë me ekspertizën e duhur dhe që argumenti është brenda që të zbatohet thjesht legjislacioni europianë edhe në Shqipëri. tha Jaka.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

### NJOFTIM – SHPALLJE

#### PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E "VAKANCËS SË PARAKOSHME" TË KRIJUAR PËR VENDIN GJYQAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 93, 125, 127 pikat 1/c, 2, 3, dhe nenit 179 pika 2 të Kushtetutës, nënve 7 pika 2, 7/a, 7/b, 7/dh pika 2, 86 pika 4 shkronja "c", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 9, datë 24.10.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, njoftuar nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr. 380/4 prot, datë 29.10.2018, me cilësinë e organit të emërtësës, me qëllim plotësimin e "Vakancës së parakoshme", të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, dhe me cilësinë e organit të emërtësës me Dekretin nr. 10946, datë 09.11.2018, ka miratuar;

n Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për plotësimin e "Vakancës së parakoshme" të krijuar nga përfundimi përpara kohe i mandatit, të ish-gjyqtarës Znj. Altina Xhoxhaj, sipas vendimit nr. 9, datë 24.10.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

#### Presidenti i Republikës fton;

Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e vendit dhe nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë të hapur publik, për vakancën e mësipërme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës;

- Kërkesën për shpejten e interesit për të kandiduar për vendin vakant të shpallur;
- Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/email);
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dokumentacionin shoqërues nëpërmjet të cilit vërteton përbushjen e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Formularin e vetëdeklarimit të plotësuar dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Formulari i vetëdeklarimit, është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Formularin e aplikimit të plotësuar "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", formular ky i cili është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Listë të dokumentacionit të dorëzuar, të firmosur nga aplikanti.

Për lehtësinë e të gjithë aplikantëve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, më poshtë gjëni të botuar përbashkët nën 125, pika 4 e 5 të Kushtetutës dhe nenit 7/a, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese,

#### ■ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

##### Neni 125

4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor të së drejtës, nëpërmjet të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.
5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

#### ■ Ligji nr.8577, dt 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

##### Neni 7/a

#### Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përbush këto kushte:
  - a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
  - b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
  - c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
  - d) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një veprë penale;
  - e) të mos jetë larguar nga detyra për shkak disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
  - f) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:
  - a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
  - b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
  - c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

#### 3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:

- a) vjetërsisë në profesion;
- b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese ose Gjykatës së Lartë;
- c) kualifikimeve pasunivërsitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
- d) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
- e) ecuresis gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlerëshme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimi përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;
- dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

4. Organet e emërtësës marrin parasysh përberjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore. Kërkesa dhe dokumentat shoqëruese mund të dorëzohet me postë ose drejtpërdrejt në ambjentet e Institucionit të Presidentit të Republikës, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1 Tiranë, Kodi Postar 1001.

#### Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm, është brenda datës 26 nëntor 2018.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikantëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës dhe me mijetë e informimit publik, dhe menjëherë dosjet respektive për secilin aplikant do t'i përcillen Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vlerësim sipas ligjit.

Institucioni i Presidentit të Republikës, do të bëjë transparente çdo rezultat të këtij procesi në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e parashikuar në nenin 7/b, të ligjit nr.8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Për çdo sqarim mos hezitoni të kontaktoni në këto të dhëna kontakti:

Numri telefonit: 042389898

**TIRANË** - Në Prokurorinë e Tiranës kanë mbërritur letërporositë e kërkuara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për hetimin që po kryhet për kontratat e lobimit të Partisë Demokratike të vitit 2017. Sipas TV Klan, mësohet se dy letërporositë sqarojnë mënyrën e përdorimit dhe origjinën e rreth 600 mijë Dollarëve të përdorur nga PD për lobim në Washington. Prokuroria po tregohet tepër diskrete pa



## Hetimi për kontratat e lobimit të Partisë Demokratike, Mbërrinjë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës 2 letërporosi

dhënë detaje mbi përgjigjet që kanë sjellë autoritetet amerikane, duke qenë se në këtë fazë përbëjnë sekret hetimor. Mazhoranca e akuzon opozitën se këto para janë financuar nga oligarkët rusë apo persona të lidhur me ta. Por Partia Demokratike ka mohuar një gjë të tillë duke sqaruar se kontratat

janë transparente. Në prokurori u pyetën edhe zyrtarë të kësaj partie, si ish-sekretari Arben Ristani dhe financieri i partisë. Të dy mohuan se janë përdorur para që vinin nga financues të dyshimtë. Janë rreth 600 mijë dollarë të përdorura në tre kontrata të ndryshme, dy me kompaninë "Stonington Strategies" dhe

tjetra me "Barnes and Thornburg LLP". Të dyja këto kompani janë të regjistruar në parajsat fiskale. Qëllimi i kontratave ishte sigurimi i takimeve me zyrtarë të nivelit të lartë të administratës së Presidentit Donald Trump apo edhe intervista në media të ndryshme atje.

Reagon PD: Vendim politik i Edi Ramës, nuk do ia mbyllin dot gojën opozitës

**TIRANË**

Prokuroria e Tiranës ka marrë të pandehur ish-deputetin e Partisë Demokratike, Ervin Saliانjin për çështjen e njohur si "Xhafaj-Babale". Ai është thirrur të premtën më 8 mars për t'u njohur me akuzat e prokurorisë. Pak ditë më parë Saliانji është ankuar për zgjatjen e afateve të hetimit. Ai e ka cilësuar tërësisht në shkelje të ligjit zgjatjen e afateve të hetimit nga organi i akuzës për çështjen "Babale-Xhafaj", për të cilën ai dhe gazetari Olldashi janë në hetim për akuzën e "kallëzimit të rremë". Më herët deputeti ka sqaruar në prokurori se, për audiopërgjimin "Babale-Xhafaj", nuk ishte ai ndërmjetësi i takimit Olldashi-Albert Veliu (personi që akuzoi vëllain e Fatmir Xhafajt për trafik droge). Ndërsa për videon e dytë me aktorin e këtij përgjimi, Fredi Alizoti, deputeti shpjegoi se ia kishte dhënë shtetasi Florenc Hoxha. Sakaq, avokati i Ervin Saliانjit tha se: "Prezidentimet tona kanë të bëjnë me ankimmimin tonë për moszgjatjen e hetimeve. Kërkojnë të zvarrisin procesin duke pyetur të njëjtin person, siç është Fredi Alizoti. Gjykata do shprehë tërësisht nënën për ankimmimin. Dosja është transferuar nga njëra gjykatë tek tjetra". Përveç ish-deputetit të PD-së, Ervin Saliانji, nën hetim janë dhe Albert Veliu protagonist i videopërgjimit dhe i afërmi i tij, Fredi Alizoti, që sipas prokurorisë ka imituar zërin e Agron Xhafajt, vëllait të ish-ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, si dhe gazetari Jetmir Olldashi. Sipas përgjimeve të prokurorisë, Fredi Alizoti, në biseda telefonike me "Babalen" por edhe persona të tjerë si Florenc Hoxha dhe Erzen Breçanin, ish-polici në kohën e PD-së, thotë se zërin e Agron Xhafajt e ka bërë ai, si dhe për vëntien në

# Audiopërgjimi "Xhafaj-Babale", prokuroria e Tiranës merr të pandehur Ervin Saliانjin

## Ish-deputeti demokrat akuzohet për kallëzim të rremë



Albert Veliu



Ervin Saliانji



**Shkarkimi i Sevdarit, Arta Marku thirrje për aplikime në KLP**

**TIRANË** - Pas shkarkimit nga detyra të prokurorës dhe anëtares së KLP Antoneta Sevdari nga Kolegji i Posaçëm Apeli, kryeprokuroerja Arta Marku u ka bërë thirrje prokurorëve të aplikojnë për anëtar në KLP në vendimin e firmosur nga Marku, anëtar i ri i KLP do të plotësojë vendin e mbetur vakant pas shkarkimit të Sevdarit. Mësohet se Arta Marku u ka kërkuar prokurorëve që të dorëzojnë aplikimet për këtë vend vakant brenda 15 ditëve. Prokuroria Sevdari kaloi pa probleme në KPK, por Komisioneri Publik deklaroi se vendimi i Shkallës së Parë është marrë pa u bërë një hetim i thelluar të paktën në dy kritere. Me sa duket pasuria e bashkëshortit të saj ka sjellë edhe verdiktin final për shkarkimin.

jetë të këtij skenari do paguhehshin 200 mijë euro nga Saliانji. Alizoti që tashmë ndodhet në burg, shprehej i zhgënjyer me Albert Velium, i cili nuk i ka dhënë asnjë lek dhe ishte larguar për azil. Pasi u arratis fillimisht në Kosovë ku kërkoi për disa muaj azil politik, Albert Veliu përfundoi në fillim të këtij viti në Belgjikë. Ndërkohë që çështja për Babalen (Albert Velium) dhe kunatin e tij është e veçuar për shkak se hetimet ndaj Saliانjit nisën në kohën kur ai ishte deputet. Ndërkaq, çështja pritet që të përfundojë në gjykatë. Ndërkohë që pas publikimit të audiopërgjimit vëllai i ish-ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj, Agron Xhafaj la ka-

mpionin audio të zërit të tij në prokurori dhe u largua për t'u dorëzuar drejtësisë në Itali ku kishte për të vuarur edhe 4 vite burg. Pas marrjes i pandehur të Saliانjit ka reaguar PD, sipas së cilës vendimi i prokurorisë është vendimi politik i kryeministrit Rama. Në reagim zyrtar thuhet se i akuzuar për "kallëzim të rremë" është denoncuesi, pra në këtë rast Saliانji dhe jo ai që bën krimin. "Rama e prokuroria nuk do t'ia mbyllin gojën opozitës", deklaroi PD.

**REAGIMI I PLOTE I PD**  
Prokuroria nuk zhgënjëu dhe sot, kur zyrtarizoi vendimin politik të Edi Ramës për marrjen të pandehur të Ervin Saliانjit. Asnjë sur-

prizë nuk ka në këtë vendim, ku i akuzuar është denoncuesi dhe jo ai që bën krimin. Denoncimi i Partisë Demokratike faktot përfshirjen në trafik droge të vëllait të Ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj dhe mbështetjen që i siguron ai nga funksioni publik. Falë këtij denoncimi: Agron Xhafaj, vëllai i ministrit të Brendshëm, nuk vazhdon të merret me trafik droge, por është në burg në Itali për trafik ndërkombëtar droge. Fatmir Xhafaj u shkarkua si ministër i Brendshëm, duke mos përdorur më pushtetin e tij politik të favorizuar të vëllain në trafik droge. Taulant Balla dhe Ardi Veliu u faktuan si manipulorët e çështjes, duke fabrikuar prova e dëshmitarë, me qëllimin e vetëm mbrojtjen e Ministrit të Brendshëm dhe vëllait të tij trafikant droge. Vendimi politik i prokurorisë është paralajmëruar nga Edi Rama që ditën e parë të zbulimit të skandalit nga Partia Demokratike. Akti i sotëm dëshmoi, edhe njëherë se, për sa kohë Edi Rama të jetë në qeveri, drejtësia i ka duart e lidhura dhe krimi i organizuar do të jetë i paprekshëm. Edi Rama dhe prokuroria e tij politike nuk do t'ia mbyllin dot gojën opozitës! Partia Demokratike është e vendosur të denoncojë çdo aferë që provon se qeveria Rama është produkt dhe peng i kimit të organizuar.

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e pare për pasurinë :  
1- Truall , me sipërfaqe 250 m2 dhe sipërfaqe ndërtëse 85m2, e ndodhur në Blinçke, Devoll, në Zonën Kadastrale 1202, Numri i Pasurisë: 1831/50, Vol. 23. Faqe 70, në pronësi të Vasil Ferit Muzeku Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën 8.000 (tete mijë euro) EURO ose 1.000.000 (nje milion) LEKE.  
Ankandi i pare për pasurinë e mesipërme zhvillohet me datë 15.03.2019 , ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përbaruese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr."Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 0699381883 .

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e trete për pasurinë :  
1-"Are", me sipërfaqe 1.200 m2, e ndodhur në Katund i Ri, Tiranë në Zonën Kadastrale: 2119, Numri i Pasurisë: 97/1/1, Vol. 2, Faqe. 197/61 në pronësi të Albert Seadin Duka Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën 19.152 (nënetëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) EURO ose 2.394.000 (dy milion e treqind e nënetëdhjetë e kator mijë ) LEKE.  
Ankandi i trete për pasurinë e mesipërme zhvillohet me datë 01.04.2019 , ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përbaruese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr."Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 0699381883 .

**NJOFTIM ANKANDI**

Përbaruesi Gjyqësor Privat Neritan Çuko, në datën 20.03.2019 ora 16:00 zhvillon ankandin e Pare, për shitjen e pasurisë së palajqësme të llojit "Apartament me sipërfaqe 65 m2, me numer pasurie 410/168/ND+1-19, në volumn 1, faqe 110, hyrja 1, apartamenti 19, në zonën kadastrale nr. 2832, në Orkum ,Vlore, në pronësi të Albert Sali Troqe, me debitor Tonin Troqe. Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi është EUR 23.200 (nëzete e tremjete e dyqind euro).  
Për çdo informacion mund të kontaktoni: Cel: Neritan Çuko: 0686065334; E-mail: neritançuko@gmail.com.

Ngjarja në janar të 2017-ës, sasia e madhe e drogës u sekuestrua në Ankona

TIRANË

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka dënuar anëtarët e grupit të strukturuar kriminal, të cilët në janar të vitit 2017 trafikuan nga porti i Durrësit në Itali 2.5 tonë kanabis. Ngarkesa me drogë kishte si destinacion Gjermaninë, por nuk mbërriti atje pasi u bllokua në Ankona. Gjatë seancës së djeshme gjyqësore, i pandehuri Aurel Lazaj përfitoi një masë tejet të shkurtuar falë bashkëpunimit me drejtësinë shqiptare. Lazaj nga 16 vite burg u dënua me vetëm 2 vite, me statusin dëshmitar i mbrojtur i drejtësisë. Ndërkohë, Euron Hoti, i cili akuzohet se ishte në krye të grupit është dënuar me 15 vite burg, dhe Malton Lleshi me 13 vite burg. Ndërkohë, efektivët e policisë në Portin e Durrësit, Gëzim Dervishi (ish-specialist në trajtimin e qenve) dhe Agron Kapllanaj (ish-punonjës policie, trup shërbimi, shoqëruar qeni në Portin e Durrësit), u dënuan me nga 2 vite burg secili, për shpërdorim detyrë. Doganieri Mikail Hilaj u dënua me 2 vite burg, ndërsa kolegu i tij doganier, Altin Katundi (ish-agjenti doganor) u shpall i pafajshëm. Një nga të arrestuarit në operacionin e policisë, Demo Progonati, ndërroi jetë në spital pasi ishte i infektuar me virusin HIV-AIDS. Në lidhje

# Trafikuan 2.5 tonë kanabis drejt Italisë, dënohen me 36 vite burg 6 anëtarët e grupit

## Gjykata shpall të pafajshëm ish-agjentin doganor në Durrës, Altin Katundi



Droga e sekuestruar në Ankona, Itali

me të njëjtin rast, në një procedim të ndarë është duke u gjykuar edhe një grup tjetër, ku si i pandehur është marrë edhe nënkomisari i Fierit, Festim Lelaj. Sipas Prokurorisë, zyrtari i policisë ishte një

ndër personat më të rëndësishme të grupit. Sasi e drogës prej 2,5 ton kanabis u zbulua më 9 janar të vitit 2017-ës, ku u arrestua edhe shoferi Dhimo Koraj. Në listën e pasagjerëve, figuronte si shofer i

këtij kamioni të nisur nga Durrësi, Demo Progonati, 46-vjeçari, i lindur në Progonat dhe banues në Fier; i arrestuar 6 ditë pas sekuestrimit të drogës, më 15 janar. Pas arrestimit të Progonatit dhe

### DËNIMET PËR GRUPIN E DROGËS

- |                    |                           |
|--------------------|---------------------------|
| 1. Aurel Lazaj     | 2 vite burg (nga 16 vite) |
| 2. Euron Hoti      | 15 vite burg              |
| 3. Malton Lleshi   | 13 vite burg              |
| 4. Gëzim Dervishi  | 2 vite burg               |
| 5. Agron Kapllanaj | 2 vite burg               |
| 6. Mikail Hilaj    | 2 vite burg               |
| 7. Altin Katundi   | u shpall i pafajshëm      |

### ZYRTARI I POLICISË

Në lidhje me të njëjtin rast të trafikut të drogës, në një procedim të ndarë është duke u gjykuar edhe një grup tjetër, ku si i pandehur është marrë edhe nënkomisari i Fierit, Festim Lelaj. Sipas prokurorisë, zyrtari i policisë ishte një ndër personat më të rëndësishme të grupit. Sasi e drogës prej 2,5 tonë u zbulua dhe u sekuestrua më 9 janar të vitit 2017 në Ankona të Italisë.



### Arrestohen 2 shqiptarë me

400 mijë euro heroinë

**ITALI** - Dy shqiptarë janë arrestuar mbrëmë në zonën e Firences. Sipas mediave vendase, të arrestuarit janë të moshave 25 dhe 33 vjeç. Ata u ndaluan pas një aksioni kundër lëndëve narkotike, ndërsa karabinierët konstatuan se shqiptarët mbanin një sasi droge prej 8 kg heroinë, vlera e së cilës llogaritet në 400 mijë euro. Veprimet e shqiptarit 25-vjeçar, i cili po drejtonte makinën tip 'Fiat Punto' ka bërë që të shtohen dyshimet tek autoritetet, të cilat më pas gjetën të fshehur sasinë e drogës në një pjesë të makinës. Kontrollët nuk mbaruan këtu. Ata vijuan edhe në shtëpinë e 33-vjeçarit shqiptar tekta u vërtetua se ai e kishte kthyer shtëpinë një laborator herione. Pas heroinës, u sekuestruan edhe pajisjet të cilat shërbenin për ndarjen e sasisë në doza të vogla.

**Tirana International Airport**  
Nënë Tereza

**TENDER NOTIFICATION**

**PEST MONITORING AND CONTROL FOR PREMISES (3D SERVICE)**  
**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k (TIA) is requesting offers for pest monitoring and control for premises (3D Service).

TIA is looking to contract a company to undertake these services that will consist in general terms of: Pest monitoring and control service for disinfection, disinsection and deratization (3D) service and to maintaining a good level of hygiene, very good sanitary conditions, healthy and clean environment, safe operational premises, in order to prevent as well the spread of the infection or contamination and any animal hazard within TIA premises.

To participate in this process interested parties will need to submit their interest for participation by e – mail, to all below e – mail address, until 20 March 2019.

Upon receipt of the e – mail, TIA will send to the respective company a Confidentiality Commitment form.

The interested company will need to send the signed and stamped Confidentiality Commitment form, by e-mail, at all the e – mail address below, and only then they will receive all the necessary forms and instructions for participating in this tender.

The set of tender documents will be delivered free of charge, via e-mail.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "PEST MONITORING AND CONTROL FOR PREMISES (3D SERVICE)" The address for submission of offers is:

**Tirana International Airport sh.p.k**  
Administration Building  
Rinas, Tirana  
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 20 March 2019.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:  
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

Tirana International Airport SHPK  
Tirana International Airport Nënë Tereza, Administration Building, Rinas, Tirana, Albania  
Phone: 00355 4 2381 600 Fax: 00355 4 2381 545  
E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com

nisjes së hetimeve të cilat zgjatën pothuajse 1 vit, erdhën edhe një varg arrestimesh duke krijuar një furtunë në doganën e Durrësit. Vetëm 6 muaj më vonë, më konkretisht në muajin qershor u arrestuan edhe 3 trafikantë të tjerë, Euron Hoti, Malton Lleshi dhe Aurel Lazaj, ky i fundit tashmë bashkëpunëtor i drejtësisë. Ndërsa në dhjetor të vitit që lamë pas, u arrestuan edhe zyrtarët e portit të Durrësit Gëzim Dervishi, Agron Kapllani, Mikail Hila, Altin Katundi dhe ish nënkomisari i Policisë së Fierit, Festim Lelaj. Me arrestimet e këtyre të fundit u mbyllën hetimet paraprake për këtë grup.



## Ja zonat ku shpërndanin kokainën, kokat e grupit kriminal, "Pipo" dhe "Loli i Verës"

**TIRANË** - Një ditë pas finalizimit të operacionit të koduar "Laboratori", ku u sekuestruan 1800 gr heroinë dhe 200 gr kokainë, janë zbardhur detaje të reja nga policia. Mësohet se koka e grupit ishte 30-vjeçari Florian Nurja, i cili njihet me pseudonimin "Loli i Verës". Ai bashkëpunonte me 27-vjeçarin Peraldo Pelushi, i njohur edhe me pseudonimin "Pipo". Të dy këta persona kishin përshtatur një apartament në "Rugën e Kavajës", ku përpunonin lëndën narkotike dhe e ndanin në doza me të vogla dhe më pas ua shpërndanin shpërndarësve të dorës së dytë. Policia në bazë të informacioneve i gurmoi dhe i ndaloi në rrugë duke udhëtuar me një automjet brenda të cilit u gjetën 4 peshore elektronike. Pas kontrollit të banesave u zbulua dhe lënda narkotike. Ndërkohë që katër persona të tjerë janë proceduar në gjendje të lirë për moskallëzim krimi dhe shitje droge. Policia vijon hetimet për zbulimin e gjithë rrjetit. Ky grup heroinësh dhe kokainësh e shpërndanin në Selitë, "Rruga e Kavajës", në zonën e ish-Parkut, Kombinat dhe Yzberisht, pasi aty kishin dhe pikat e tyre të kontaktit.



Gjatë prezantimit të projektit të bursave në Austri

Rektori Ethem Ruka vlerëson marrëdhëniet mes dy vendeve: Të forta e solide

Voltiza Duro

# Ambasadori austriak prezanton projektin e bursave në universitetin "Luarasi"

*Jonah Sattler: Aplikimi për të përfituar deri më 29 mars*

Shkëmbimi i eksperiencave dhe ofrimi i bursave në vende të ndryshme të botës, është përparësi për studentët që synojnë një karrierë të suksesshme në të ardhmen. Në kuadër të projekteve të mobilitetit, ambasadori austriak në Shqipëri, Johan Sattler, ishte i pranishëm në universitetin "Luarasi". Ai prezantoi para studentëve procedurën e aplikimit për bursa në shkollën verore në Alpbach të Austrisë dhe iu bëri thirrje që të përfitojnë nga kjo mundësi, e vlefshme deri më 29 mars. "Është një kënaqësi për mua të jem sot këtu në universitetin tuaj. Alpbach është një fshat i vogël në Austri i quajtur ndryshe si "vendi i mendimtarëve". Ky vend sjell së bashku këndvështrime e dimensione të ndryshme, jo vetëm në politikë e ekonomi por edhe në çështjet sociale e në art. Është një panoramë e gjerë ku rreth 5 mijë të rinj nga Europa dhe bota mblidhen për shkëmbim përvojash. Nëse mendoni se projekti iu intereson, duhet të aplikoni për të përfituar nga bursat që ne ofrojmë çdo vit", tha ambasadori austriak.

## MARRËDHËNIET SHQIPËRI-AUSTRI

Rektori i universitetit "Luarasi", prof. dr Ethem Ruka, tha se marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Austrisë janë solide dhe po përmirësohen dita-ditë në fushën e arsimit, ekonomisë e politikës. "Jemi shumë të nderuar që jeni këtu midis nesh. Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Austrisë janë marrëdhënie të vjetra, të forta, solide. Austria gjithmonë e ka mbështetur Shqipërinë, si në ditë të mira, edhe në ditë të vështira, e padyshim një rol të rëndësishëm për këtë luan edhe zoti ambasador. Nga viti në vit, marrëdhëniet mes dy vendeve kanë ardhur duke u fuqizuar jo vetëm në fushën e politikës, por edhe në atë të biznesit, kulturës e arsimit", tha



Ambasadori austriak në universitetin "Luarasi"



## TURIZMI NË SHQIPËRI

"Shqipëria ka ende nevojë që të zhvillohet përsa i përket turizmit, pasi përveç promovimit të pasurive natyrore, nevojitet një zhvillim më i madh i infrastrukturës. Ka ende shumë për tu bërë në Shqipëri, por më e rëndësishmja është që ju si studentët, të angazhoheni, të përpiqeni që zëri juaj të dëgjohet dhe të bëheni pjesë e atyre shqiptarëve që dëshirojnë progresin e vendit", -shtoi Sattler.

## BASHKËPUNIMI

"Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Austrisë janë marrëdhënie të vjetra, të forta, solide. Austria gjithmonë e ka mbështetur Shqipërinë, si në ditë të mira, edhe në ditë të vështira, e padyshim një rol të rëndësishëm për këtë luan edhe zoti ambasador. Marrëdhëniet mes dy vendeve kanë ardhur duke u fuqizuar jo vetëm në fushën e politikës, por edhe në atë të biznesit, kulturës e arsimit", -tha Ruka.

Ruka. Më tej ky i fundit pohoi se studentët do të aplikojnë për të përfituar nga kjo përvojë e shkëmbimit të kulturave.

## PROBLEMATIKAT NË VEND

Në fjalën e tij ambasadori austriak u ndal edhe në pro-

movimin e turizmit në Shqipëri e shtoi se nevojitet një sistem dhe një infrastrukturë më e zhvilluar për turistët

vendas e të huaj. Sattler tha se studentët duhet të flasin për problematikat dhe të përpiqen më shumë për progresin e vendit. "Shqipëria ka ende nevojë që të zhvillohet për sa i përket turizmit, pasi, përveç promovimit të pasurive natyrore, nevojitet një zhvillim më i madh i infrastrukturës. Është një sfidë që duhet ta çoni deri në fund, duhet të gjeni një sistem. Ka ende shumë për t'u bërë në Shqipëri, por më e rëndësishmja është që ju si studentët, të angazhoheni, të përpiqeni që zëri juaj të dëgjohet dhe të bëheni pjesë e atyre shqiptarëve që dëshirojnë progresin e vendit", -shtoi Sattler.

## PROJEKTI

European Forum Alpbach është një ndër forumet më jetëgjatë e të suksesshëm në Europë, në të cilin marrin pjesë më shumë se 3000 studentë nga 80 vende të botës, pedagogë nga Universitetet më të njohura Europiane, specialistë dhe profesionistë të spikatur nga fusha të ndryshme, liderë politikë, etj. Universiteti "Luarasi" përgjatë viteve ka mbështetur studentët për pjesëmarrje në këtë

**ROLI I UNIVERSITETIT**  
Universiteti "Luarasi" përgjatë viteve ka mbështetur studentët për pjesëmarrje në këtë platformë, e cila është sa akademike ashtu edhe ekstrakurrikulare, gjë që i shërben jo vetëm jetës studentore por edhe pasurimit të kurrikulës së çdo studenti.

platformë, e cila është sa akademike ashtu edhe ekstrakurrikulare, gjë që i shërben jo vetëm jetës studentore por edhe pasurimit të kurrikulës së çdo studenti. European Forum Alpbach u themelua në 1945 në Alpbach, Tirol, Austri i quajtur edhe si "Fshati i mendimtarëve" nga Otto Molden. Forumi synon të përhapë frymën e tolerancës nëpërmjet dialogut konstruktiv, duke përzier brezat dhe kombet për të trajtuar çështjet globale, për të nxitur zhvillimin kulturor dhe ekonomik dhe për të inkurajuar integrimin evropian. Objektivi kryesor i Forumit European Alpbach (EFA) është lidhja e vendimmarrësve ndërkombëtarë nga të gjithë sektorët e shoqërisë me një audiençë të interesuar dhe të nxituar në mënyrë që të krijohet një forum diskutimi ndërdisiplinor për debatim nëpër barrierat gjeneruese, ideologjike dhe të tjera që ndajnë të rinjtë. Sipas forumit, angazhimi për të mbështetur shoqëritë pluraliste dhe demokratike të udhëhequra nga fryma e tolerancës gjërdh nga vullneti për të kontribuar në një botë më të mirë.

**SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k**  
Rr. "Fsh Daa", Kompleksi Kk2, Kulla 5, Kt. 1, Tiranë  
Web: www.3h.al, Email: shqg\_3h@yahoo.com, tel: 0692029711

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.28.02.2019 deri në dt. 11.03.2019 per: sendin e luajtshem mjete me targe DR 9619 D në pronesi te Hynsi Gjergji Cnimi fillestar eshte 800 EURO

Ankandi zhvillohet ne zyrën perbarimore ne daten 11.03.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00

**Medar KAJOLLI** Përmbareus Gjyqësor Privat me seli ne Rr."Urani Pano" Pll.1/3, Kati-2, Tiranë, nxjerr ne shitje ne ankand pasurite e paluajtshme si me poshte:  
Nr.Regjistri Hipotekor 717, datë 12.10.2018, me Sip.-200 m2, Zk. 3844, Lloji Dyqan Shitje Industriale, ndodhur në Vuno, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë, me vlerë 4,151,280 (Katër milion e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë) Lekë.  
- në pronesi te debitorit Z.Spiro Ekonomi.  
Shitja e pasurive te paluajtshme do te behet (Zhvillohet) ne date 11.03.2019, ditën e Hënë, ora 16.00 ne Zyrën e Përmbareusit Gjyqësor Privat Z. Medar KAJOLLI, ne Adresën Rrugën "Urani Pano", Pll.-1/3, Kati-2, Tiranë.

Per informacione mund te kontaktoni  
Nr.Tel:+355 66 20 333 03, ose ne Adr.-email:medar.kajolli@yahoo.com



**Danielsson në takimin me Daçiç: Të pezullohet taksa urgjent**

**Ambasadori i SHBA: Çelësi për Beogradin e Prishtinën, kthimi në tryezën e negociatave**

Drejtori i Përgjithshëm për Fqinjësi dhe Zgjerim në Bashkimin Evropian, Christian Danielsson, ka përsëritur dje kërkesën e Komisionit Evropian që Prishtina të heq takson ndaj produkteve serbe. Ai ka thënë se për veprimet që po e pengojnë vazhdimin e procesit do të kenë pasojë të dëmshme. Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, Ivica Daçiç, është takuar dje me Drejtorin Gjeneral për Politikë të Fqinjësisë së Mirë dhe Zgjerim të Bashkimit Evropian, Christian Danielsson. Në këtë takim është diskutuar për rrugën e integritetit të Serbisë në Bashkimin Evropian, ndërse Danielsson ka thënë se



i gjithë rajonit duhet të përfitojnë nga momenti i krijuar, pasi sipas tij përbërja aktuale e institucioneve të BE-së është shumë e hapur ndaj rajonit të Ballkanit Perëndimor. Sa i përket qëndrimit të qeverisë së Kos-

ovës për takse ndaj produkteve serbe, Danielsson ka thënë se Komisioni Evropian ka i ka bërë thirrje Prishtinës në mënyrë urgjente dhe shumë të qartë për ta pezulluar takson, shkruan "novosti". Danielsson ka thënë se për të gjitha ato veprime që po e pengojnë vazhdimin e procesit, do të ketë pasojë. Megjithatë në Kosovë ka polarizim të skajshëm sa i përket takses. Në njërin anë kryeministri Haradinaj që nuk e heq takson pa një marrëveshje ku Serbia e njeh Kosovën si shtet, dhe në anën tjetër partneri më i madh i koalicionit dhe njëra

nga partitë më të mëdha opozitare kërkojnë që taksa të pezullohet pas thirrjeve dhe presionit të SHBA-së. Nga ana tjetër ambasadori Amerikan në Serbi, Kyle Scott ka thënë se Amerika nuk mendon ndonjë vijë të kuqe kur është fjala rreth arritjes së një marrëveshje të mundshme, ndërmyet Kosovës dhe Serbisë. Kyle Scott ka thënë se çdo zgjidhje e pranuar nga të dyja palët do të mbështetet, e cila mund të zbatohet dhe të jetë e përhershme. Ndërsa duke folur për rolin e ardhshëm të Philip Reeker, njeriu i sapoemëruar amerikan për Ball-

kanin, Scott ka thënë se "ai nuk ka ndonjë plan në xhepin e tij", siç ishte spekuluar në javët e fundit. "Mund të them atë çfarë e ka thënë presidenti amerikan, se Kosova dhe Serbia duhet të përpigjen për një marrëveshje për normalizimin dhe që në zemër të kësaj marrëveshjeje duhet të jetë një marrëveshje për njohje reciproke. Por marrëveshja për normalizimin duhet të përfshijë shumë gjëra të tjera: marrëveshjen e marrëdhënieve ekonomike, zgjidhjen e statusit të Kishës Ortodokse Serbe (SPC), çështjen e personave të zhdukur, krimet e luftës ... Ka shumë elemente që duhet të përfshihen në marrëveshje, por ne besojmë se njohja e ndërsjellë duhet të qëndrojë në zemër të marrëveshjes së normalizimit", ka thënë ndër të tjera Scott. Ai ka folur edhe rreth vendosjes së takses nga Qeveria e Kosovës për produktet nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. "Çelësi për Beogradin dhe Prishtinën është kthimi në tryezën e negociatave. Kjo duhet të jetë prioritet i të gjithëve. Disa njerëz luajnë lojëra, kanë taktika, tërheqin disa lëvizje, por qëllimi për Kosovën është të arrijë një marrëveshje dhe e vetmja mënyrë është që të kthehen në tryezën e negociatave. Megenjëse këto tarifa të vëna nga Prishtina kanë penguar vazhdimin e procesit të negociatave, mendojmë se ato duhet të shfuqizohen menjëherë. Ne kërkojmë nga Kosova që të pezullojë ato për një periudhë që lejon vazhdimin e negociatave. Unë shpresoj se ata do të na dëgjojnë", ka thënë ambasadori amerikan në Beograd, Kyle Scott.

**Conte kritikon Kosovën: Vendimet e njëanshme nuk çojnë askund**

**Taksa ndaj Serbisë, Italia e Anglia thirrje Kosovës: Të hiqet**

*Haradinaj: Jam ushtari i parë i SHBA në vijën e frontit me Rusinë*

Ditën e djeshme Alan Duncan, ministri britanik, ka deklaruar se tensionet në rajonin e Ballkanit Perëndimor, kryesisht ato mes Kosovës dhe Serbisë për shkak të aplikimit të takses, po minojnë stabilitetin ekonomik. Ai bëri thirrje që Kosova të heqë dorë nga taksa dhe të nisë punën për dialog me Serbinë, pasi sipas tij, kjo është e vetmja rrugë që do të sjellë një të ardhme më të mirë për qytetarët e të dyja vendeve. Ditë më parë kanë apeluar që të hiqet taksa për mallrat e Serbisë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por autoritetet kosovare nuk kanë bërë asnjë lëvizje në këtë drejtim. "E kemi parë Serbinë duke i nxitur shtetet që ta tërheqin njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe e kemi parë Kosovën duke i vendosur tarifa 100 për qindëshe mallrave serbe dhe atyre nga Bosnja e Hercegovina. E gjithë kjo e heq mendjen nga dialogu i lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve. Ne dëshirojmë që Kosova dhe Serbia ta kapin mundësinë për marrëveshje, duke u inspiruar nga lidhshipi i Greqisë dhe asaj çfarë tani është Maqedonia e Veriut në arritjen e marrëveshjes për ta zgjidhur çështjen e shumë zgjatuar të emrit. Ne besojmë se progresi në mes të Serbisë dhe Kosovës është i mundur dhe urgjentisht i nevojshëm, por se negociatat nuk duhet të jenë rreth shpejtësisë, por duhet të fokusohen në arritjen e marrëveshjes më të qëndrueshme dhe optimale. Ne vazhdojmë të bëjmë presion mbi të dy palët për de-escalim të tensioneve dhe kthim në negociata. Me partnerët ndërkombëtarë, ne kemi kërkuar nga qeveria e Kosovës që t'i vendosë hapat të cilat kanë ndërmend t'i marrin për suspension të tarifave dhe për kthim në dialog. Është në interes të



Kryeministri i Italisë, Giuseppe Conte

Kosovës që ta mbajë momentumin drejt një marrëveshjeje", citohet të ketë thënë ministri britanik Duncan. Së fundmi janë shtuar vendet që i kërkojnë asaj të bëjë kthesë dhe të reflektojë për të hequr barrierën tregtare. Pas SHBA dhe Anglisë, dje ka qenë Italia, e cila i ka kërkuar Kosovës të heqë takson e aplikuar për Serbinë. Ka qenë presidenti italian, Giuseppe Conte, i cili është shprehur se rruga që po ndjek Prishtina zyrtare është e gabuar, ndërsa theksoi se palët duhet të reflektojnë dhe të shohin drejt dialogut si e vetmja alternativë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. "Unë e përsëris, sipas mendimit

tim, vendimet e njëanshme të marra nga Prishtina nuk dërgojnë askund. Mendoj se e vetmja mënyrë për të shpejtuar rrugën drejt dialogut është që të gjitha palët të tregohen të mençura", ka thënë Conte në një konferencë të përbashkët me Aleksandër Vuçiqin. Ndërkaq kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj shpesh për një marrëveshje me Serbinë, ndonëse është i vendosur të mos ulet në tryezën e bisedimeve me kushte. Haradinaj në një intervistë për TVSH tha se vendosmëria për të mos hequr takson për mallrat e Serbisë nuk është kundërvënje ndaj SHBA. "Mos ta bindim veten se bëhemi më miq me Amerikën duke ja hequr tak-

sën Rusisë se Rusisë ia kemi nxjerrë ne, jo Serbisë. Një ditë prej ditësh Amerikës i leverdis që Kosova të jetë vetvetja, jo që gjithë kohën t'i japë detyra dikush. Kjo temë ka të bëjë jo me Amerikën, por me Serbinë dhe Rusinë dhe unë jam vija e frontit, pra jam ushtari i parë i Amerikës në vijën e frontit me Rusinë. Nuk e kam dallimin me Amerikën. E kam dallimin me armikun tim të qindra vjetëve e për të cilin dua edhe unë të kem opinionin si të zgjidhet problemi im me ta - se jam pjesë e saj. Nuk mundet dikush të më tregojë mua si do të zgjidhet problemi me Kosovën dhe Serbisë? Do të dëgjojem unë, se jam pjesë e saj", -tha kryeministri Haradinaj.

**ALAN DUNCAN**

"Ne vazhdojmë të bëjmë presion mbi të dy palët për evitimin e përshkallëzimit të tensioneve dhe kthim në negociata. Me partnerët ndërkombëtarë, ne kemi kërkuar nga qeveria e Kosovës që t'i vendosë hapat, të cilat kanë ndërmend t'i marrin për suspension të tarifave dhe për kthim në dialog. Është në interes të Kosovës që ta mbajë momentumin drejt një marrëveshjeje", -citohet të ketë thënë ministri britanik Duncan.

**Maqedonia e Veriut, qeveria detyron institucionet për emrin**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e ditës së martë miratoi vendimin që detyron të gjitha institucionet të bëjnë ndryshim në tabelat publike në hyrjet e tyre, lidhur me emrin e vendit. Emri duhet shkruar me pajtim me amendamentet 33, 34, 35 dhe 36 nga Kushtetuta. Ligji kushtetues për zbatimin e amendamenteve dhe Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Vendimi është marrë pas propozimit të grupit të punës ndërdikasterial për kryerjen e obligimeve nga Marrëveshja përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përkrahura në rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për ndalimin e vlefshmërisë së Marrëveshjes së Përkohshme nga viti 1995 dhe për vendosjen e partneritetit strategjik midis palëve. Qeveria në seancën i urdhëroi institucionet të kryejnë edhe kontroll nëse kanë ndryshuar të gjitha shënimet digjitale (logot, memorandumet, komunikimet elektronike, ueb-faqet, mediumet...), si dhe memorandumet, materialet e shtypura, dosjet, indikatorët, në pajtim me konkludimet nr. 4 dhe nr. 5 nga seanca e 120-të dhe në afat prej shtatë ditëve deri tek grupi i punës ndërdikasterial të dorëzojnë raport përmbledhës nëse është kryer ndryshimi i kërkuar dhe deri në cilën shkallë. Në vazhdim të kumtesës qeveritare është bashkëngjitur lista e institucioneve me titullin e ri. Me listën përfshihen gjithsej 136 institucione.

Ministria e Financave publikon listën me dosjet që ka shqyrtuar nga janari deri në tetor 2018

Ish-të përndjekurit, 5 mijë trashëgimtarët që marrin paratë

Dokumentet që duhet të plotësojë çdo përfitues

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, që nuk kanë marrë dëmshpërblimin e kështit të tretë duhet të dorë...

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria...

nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës...

Table with columns: EMER, MBIEMER, EMER, MBIEMER, KOPIJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LOGOARI BANKARE, CERTIFIKATE VDEKJE, I-KATE E TRUNGUT FAMILJAR, DESHM I TRASHIGMIE, PROKURE, CERTIFIKATE PER CDO NDRYS HIM IDENTI TETI

Table with columns: EMER, MBIEMER, EMER, MBIEMER, KOPIJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LOGOARI BANKARE, CERTIFIKATE VDEKJE, I-KATE E TRUNGUT FAMILJAR, DESHM I TRASHIGMIE, PROKURE, CERTIFIKATE PER CDO NDRYS HIM IDENTI TETI

Table with columns: EMER, MBIEMER, EMER, MBIEMER, KOPIJE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL LOGOARI BANKARE, CERTIFIKATE VDEKJE, I-KATE E TRUNGUT FAMILJAR, DESHM I TRASHIGMIE, PROKURE, CERTIFIKATE PER CDO NDRYS HIM IDENTI TETI

Table with columns for names and various categories. Includes names like GJON, MARIJE, PRENDA, NAMIK, PRANVERA, MIRELA, ARMANDO, GIOKE, DITRON, HENRIK, SKENDER, RAMADAN, XHEVAHIRE, RIZA, SALIH, VASHE, ESAT, HALIT, XHAFERR, BARAM, and HAMID.

Table with columns for names and various categories. Includes names like ALIDA, ARDIANA, SUELA, TROJAN, ANDIGONI, VANGJELO, MARIA, POLIKSENI, ANA, NJOFTIME, ZHANETA, PRANVERA, PIRO, EDJOLA, VEVE, HENO, FAIKE, PASHAKO, QERIM, QANI, NUREDIN, SHEFQET, DASHAMIR, FATMIR, LOLITE, ALBERT, HYSNIE, XHEMAL, ERMIRA, SHKENDI, ADHURIM, KOSTANDIN, MIRKE, ALEKSANDER, GIOVALIN, ANGEJLINE, MARTIN, VALENTIN, NURDIE, AISHE, XHEVE, SANIJE, ISA, AVDYLL, HYRIJE, and HALILI.

Table with columns for names and various categories. Includes names like XHEZMI, MINE, ZINET, SHKIM, SHEBI, KUTITM, FLORESHA, SHERO, DUSHKU, BAZELI, SHERO, SHERO, SHERO, and KILOMOLLARI.

Table with columns for names and various categories. Includes names like VIOLETA, LENA, MARA, MARK, LIRI, DIANA, YLLI, EDMOND, QENDRIM, NAPOLON, ASUE, DELIKO, MERZIN, VASLIE, VANGJEL, and KOL.

Table with columns for names and various categories. Includes names like JUSIF, LEF, GJELE, PRENDA, PJETER, and DRANDE.

Table with columns for names and various categories. Includes names like HANIFE, HAXHIRE, MIRJETA, ZYLFI, SHYQYRIE, and (vijon).

Rrëfihet aktorja: Futem nën lëkurën e personazhit, ja të fshehtat e projektit të fundit

# Formula e suksesit që ofron Ajsi Xhaxhaj në aktrim

"Jam një kokteili i ndërlikuar, s'mund të konsumohem masivisht"

Egla Xhemali

Ajo është rritur mes skenës dhe ngjyrave.

Një rrugëtim me momente të bukura dhe të papritura që përkohet me kalimin e saj në televizion. Aktualisht një sukses i jashtëzakonshëm në filmin "Dashuria s'mjafton", oferta për role të tjera edhe përtej kufijve, ku bie në sy mbështetja e punës intensive përjetë kësaj kohe. E kemi fjalën për bukuroshen Ajsi Xhaxhaj. Jo pak breza janë rritur me rolet e saj që kur ishte fëmijë, për ta ndjekur si moderatore në një nga televizionet më të ndjekura asokohe e së fundmi rikthehet fuqishëm në aktrim. Për "Gazeta shqiptare" Ajsi vjen në një rrëfim ndryshe për të ndarë eksperiencat e saj si aktore dhe për të zbuluar detaje që s'i kemi ditur për të, përtej shkëlqimit në skenë. Xhaxhaj na tregon për momentet më qesharake kur xhirohej "Dashuria s'mjafton", për dublat, për vështirësitë që has një aktor në realizimin e një karakteri, për çastin kur duhet të marrë një vendim brenda një kohe të shkurtër etj. Nëse do i duhej të zgjidhte mes televizionit dhe aktrimit, ajo pa asnjë dyshim do zgjidhte aktrimin. Ajsi thotë se është e besuar dhe e gjendur për miqtë e saj. Më tej, duke qeshur pohon se nuk shquhet për vendime të shpejta. Për të pranvera është stina më e përshtatshme për t'u zgjuar me buzëqeshje e për të vazhduar në po të njëjtën mënyrë ditën. Sa i përket projekteve të fundit, Ajsi ndan me ne se është protagoniste në një film me zhanër komedi-romancë. Gjithçka merr një domethënie tjetër kur puna bëhet me pasion. Zoti e ka bekuar atë me bukuri, zgjuarsia dhe aftësi, cilësi të cilat jo çdokush i posedon. Përtej suksesit me filmat, Ajsi Xhaxhaj nuk ndryshon kurrë së treguari thjeshtësi dhe shpirtin e bukur.

**Si do ta përshkruante Ajsi personazhin e saj të "Dashuria s'mjafton"?**  
Edhe pse një personazh jo me volum të madh, sërish të privilegjuar pasi kam një rol kyç në këtë film. Personazhi im në "Dashuria s'mjafton" është një personazh i qetë, jo problematik dhe shumë pozitiv, ku i dihet se si mund



të shndërrohet në "Dashuria s'mjafton" 2-shil (qesh)

**Dubla që të është dashur ta përsërisësh disa herë?**

Është një skenë në lokal, ku diskutoj me Albanin (Drilonin). Vendndodhja ishte Ferizaj/Kosovë. Nuk ishte skenë e vështirë, thjeshtë unë kisha 24 orë që kisha të përziera dhe mëngjesin e asaj dite isha mjekuar në spital. Isha shumë e këputur dhe nuk arrija dot atë që doja.

**Momenti që do e cilësoje**

**si më qesharakun gjatë xhirimeve?**

Sigurisht që skenat e puthjes. (qesh) Unë me Drilonin kemi një miqësi prej pesë vjetësh. Dhe kur- rë nuk e kemi parë njëri-tjetrin në një mënyrë ndryshe. Kur bëhej fjalë për skenat e puthjeve gjithmonë i kërkonim falje njëri-tjetrit më parë e më pas putheshim. Kjo ishte shumë qesharake.

**Të fshehtat e projektit të fundit ku je protagoniste?**

Nuk kam folur shumë për këtë projekt. Është një film me metrazh të gjatë me regji të Erion Kames. Zhanri komedi-romancë. Jam protagoniste dhe luaj rolin e një zonjushë të dashuruar. Këto muaj presim të vendoset premiera. Dhe mezi e pres, më besoni!

**Vështirësia më e madhe që has një aktor në realizimin e një karakteri?**

Unë kam një përgatitje të mëhershme sa i përket aktrimit. Mjafton të analizosh



personazhin. Për aq kohe sa historia e personazhit më është shkruar, detyra ime si aktore është të merrem me detajet, dhe të futem nën lëkurën e personazhit, duke u bërë një Ajs me histori tjetër.

**Je rritur në skenë. Mes televizionit dhe aktrimit cilën do zgjidhje?**

Kjo nuk është pyetje për mua pasi pa asnjë mëdyshje do të zgjidhja aktrimin.

Televizioni është i bukur, por kërkon kohë dhe

përkushtim. Jam e fokusuar në jetën time private dhe arsimim këto momente.

**Muzika dhe arti, në çfarë të transformojnë?**

Muzika dhe arti gjithmonë më kanë bërë të zbuloj të reja për veten. Unë i quaj stimulante. Nuk mund të them transformim, pasi çdo gjë ndodhet brenda meje, veçse kërkon stimul.

**Çfarë bën për të mbajtur afër miqtë e tu?**

Unë kam shumë të njohur, por pak miq. Jam e besuar dhe gjithmonë e gjendur tek miqtë e mi. Kaq mjafton për të pasur pranë vetes ata që dua.

**Çasti kur të duhet të marrësh një vendim brenda një kohe të shkurtër?**

Të ndërroj korsi kur jam në makinë. (qesh) Unë nuk para shquhem për vendime të shpejta, por kur marrë vendime jam e frikshme! Marrë vendime që duhen, por që ndoshta nuk dua. (qesh)

**Një lloj kokteili që do kishte emrin tënd, me çfarë shije do ishte?**

Unë jam një kokteili i ndërlikuar, një pije që s'mund të konsumohem masivisht për shkak të përbërjes. (qesh) Përdinje e lartë alkooli, në shije e butë, dhe gjejeni vet nëse deheni apo jo! (qesh)


**Koha më e përshtatshme për të jetuar bukur në një qytet?**

Padyshim, pranvera është stina më e përkryer për t'u zgjuar me buzëqeshje dhe për të vazhduar ditën njëjtë!



## Enca ndryshim drastik në pamje, nuk keni për ta njohur

Enca Haxhia është një nga këngëtares që gjithmonë i pëlqen të duket ndryshe në pamjen e saj. Prej këtij fakti ajo ka grumbulluar rreth 2 milionë ndjekës në llogarinë "Instagram". Këngëtarja ka publikuar, së fundmi një video, ku me siguri s'do ta njihni me herën e parë. Enca shfaqet me sytë ngjyrë blu teksa filmon veten dhe pyet fansat nëse duket mirë me pamjen e re. Enca mbahet si një nga këngëtares me më shumë stil, po ju mendoni kështu?



## Noizy tallet publikisht me mikun e tij, zbuloni çfarë ka ndodhur

Noizy është një ndër reperët më të mirë shqiptarë dhe gjithmonë është në qendër të vëmendjes të publikut, si për projektet muzikore ashtu edhe për jetën personale. Ai ka një numër të madh fansash dhe koncertet e tij janë të tejmbushura. Noizy është shumë aktiv në rrjetet sociale, ku publikon foto e video të ndryshme si nga koncertet ashtu edhe nga jeta private. Ai ekspozon shpesh dhe makinat e tij të shtrenjta. Ato janë aq luksoze janë saqë miku i tij nuk di t'i fusë marshin. Noizy ka publikuar disa video në 'Instastory', ku shfaqet shoku i tij Dori në Ferrari dhe reperi i jep leje që ta ngasë, por ai s'di t'i fusë marshin. S'ka faj, aq e komplikuar sa është Ferrari, do na ndodhte të gjithëve!



## "Je e shtrembër", Oriola Marashi kapet keq me fansin

Modelja Oriola Marashi është një prej femrave më të pëlqyera dhe të komentuar në show bizzin shqiptar. Ajo provokon herë pas here "flake" në rrjet, me fotot e saj përvëluese, ku bien në sy format bombastike trupore. Dhe të njëjtën gjë ka bërë ditën e sotme me një video të postuar në Instagram ku duket më seksi se kurrë. "Sezoni i punës vetëm sa ka filluar, gati? Është koha për show", ky është përshkrimi që i ka vënë videos, ku shfaqet duke bërë ecjen tipike të modeleve vetëm në të brendshme. Nuk munguan komentet e shumta të fansave dhe miqve të saj, por një prej tyre ka bërë një koment që e ka acaruar Oriolën. "Kockë e lëkurë, e shtrembër më keq se hunda e Luka Modriç", shkroi ai, por Oriola nuk ia përtoi pasi iu kthye: "Idiot njeri, si mund ta shash një femër pavarësisht shijes tënde fshatareske".



## Lori Hoxha çmendet, kërkon dikë që të ndajë shtratin

Lori Hoxha është përfolur gjerësisht në mediat rozë se mund të jetë duke kaluar një periudhë jo shumë të mirë në lidhjen e saj me Vis Bajraktarin, e madje është përfolur dhe se mund të jenë ndarë përfundimisht. E megjithatë as Lori dhe as Visi nuk kanë folur publikisht për këtë gjë, por shpesh herë në postimet e tyre në 'Instagram' arrijmë të dallojmë shenja se ç'mund të ketë ndodhur mes tyre.



Së fundmi Lori është rikthyer sërish në 'Instagram' me postime të shumta, pas disa ditëve shpëputje dhe disa prej fotove na tërhoqën akoma dhe më shumë vëmendjen. Në murin ku Lori ka pozuar shkruhet: "Kam humbur arushin tim, mund të fle me ty?" E ndonëse duken si poza të zakonshme për foto në 'Instagram', mos ndoshta me këtë shprehje Lori ka dashur të na tregojë se është 'single'?



Publikohet në Fletoren Zyrtare lista me personat që u është njohur e drejta për kompensim

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën e 611 me pronarët që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilin dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosje të cilave Agjencia e Trajtimit të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohë në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të dosjeve dhe pronarët që nuk janë njohur me vendimin duhet t'i drejtohen gjykatës.

**KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK**  
Sipas formularëve-tip, mësohet se kërkuesi duhet të

# Dosjet 1993-2013, lista me 611 pronarët që marrin paratë

## Përfituesit në të gjithë vendin, ja si do të paguhen

cilësorë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës, vërtetim nga gjykata nëse vendimi përfundimtar i vlerësimit të tij është ankmuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndry-

shuar rrethi i trashëgimtarëve, prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numër llogarie, vërtetim nëse subjekti ka përfituar ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

### LLOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të

kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë sipas shkrnjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr:133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompen-

sohet fizikisht, nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr: 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave thotë se subjektet e shpronësuara u nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

### LISTA ME 611 PRONARËT QË MARRIN PARATË

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Tiranë	TODI BULI		210
Vlorë	Marko Vërçiçe	1248.9	1351.1
Durrës	Kasem Lika		0
Tiranë	SAIMIR BALLA	36	835.7
Vlorë	Zihni Hysi	2000	0
Tiranë	ESAT PAZARI	5000	89080.95
Tiranë	IBRAHIM STAJA		3100
Tiranë	REXHEPE ARJAN SHTINI		0
Tiranë	HAXHIRE MURTHI	485	376
Elbasan	Hysen Valencia	825	340
Durrës	Sabri Cela		40
Vlorë		100	0
Tiranë	NEXHAT HYLVIU		0
Tiranë	SHYQYRI SHTINI	982	0
Durrës	Mira Kaurri		660
Korçë		496	220
Durrës	Hajrije,Rgjend,Esat,Xhemal,Cjyzen e,Skender,Me Kacanja		2511
Durrës	Agim Hyka	2886	5000
Vlorë	Spiro Dhimaleksi	365	1064
Gjirokastrë	Mitat Shahini		3000
Lezhë	Pashk Tom Vuksani		0
Durrës		30	24
Durrës		5000	1695
Shkodër	Tefta Alibali	60	80.8
Tiranë	ISMAIL XIBRI	270.7	136.3
Tiranë	ZHANI PILIKA	1966	288
Shkodër	Xhevdet Myftija	2654	5476
Korçë	Dritan Mimini		5720
Gjirokastrë	Vangjel Voda	2506	600
Tiranë	HAVA ALLA	3750	3750
Fier		15396	26132
Durrës			1519
Elbasan	RIDVAN GAJDJA		250
Durrës			0
Durrës	Haki Lushi		10250
Durrës	Dibër	314.5	29461.1
Durrës			0
Durrës	Pavlina Sotiri	7325	700
Korçë	Kostandina Manastirlliu, Kristina Negovani, Naum Avushka	205	200

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Korçë	Evangjeli Llambi treska	55	0
Durrës	Ilmi Shijaku		0
Korçë	Ksanthipi Shedollari		0
Durrës			100
Gjirokastrë	Cajup Shehu	3211	1689
Lezhë	Ded Mark Tanushi	1700	5400
Korçë		145	15
Korçë		1683	3317
Tiranë	DIANA BIMBI	1900	390
Durrës			1244
Vlorë		3508	3492
Elbasan	SHYQYRI TEQJA		0
Fier	Kristaq Dimo		0
Elbasan	AHMET BALLHYSA	2910	250
Elbasan	ARBEN ABEDIN ASHIKU	30	0
Fier			0
Vlorë	Thimjo Vidheli	912	796
Vlorë	Kristaq Gjyli		0
Vlorë	Xhevit Beja	4140	2200
Korçë	Adriana Andoni		0
Korçë			31.5
Korçë			5953
Vlorë	Sherif Lilaj		0
Tiranë	PETRIT, AISHE AJAZI	5000	6040
Tiranë	Ermira Alla		853
Vlorë	Veip Rakipi		336
Tiranë	Elefteri Korra	2070	8820
Tiranë	QEMAL BARDHI	10244	557
Shkodër	Trahs Culaj	2103	6670
Korçë			90.4
Korçë		4142	230
Fier			1650
Korçë			1260
Korçë		8.4	236.6
Tiranë	REXHEP KALLUSHI		0
Vlorë	Lasko Nasti	2400	600
Korçë		330	2390
Fier	Shefikat Rustemi		0
Fier	Omer Vroni	937	740
Fier		560	7540

Korçë	Xhevdet Ali Xhuti		465
Korçë	Dhimitraq Buleçi		140
Tiranë	HASAN ALLA	1451	1347
Korçë			3099
Korçë	Ivzi Hysenbegasi	3020	1100
Korçë		5778	3406
Tiranë	TRASHEGIMT ARET BALLA		0
Durrës		7961	1904
Fier		3000	2000
Elbasan	NAIM KARAKYZJA		0
Durrës			310
Vlorë	Kosma Vllahuli	1660	0
Vlorë	Naçe Baxheri	1200	0
Tiranë	XHAVID FISNIKU	251.4	150
Tiranë	LULZIM MASHA	6220	1147
Fier	trashëgimtarët		12500
Fier	Nikollaq Meni		2790
Durrës			588
Durrës		5000	10500
Durrës	Hasije Teli	44513	12397
Korçë	Ylli Berberi	264	1436
Tiranë	EQEREM QAZIMI	816	684
Tiranë	GANI KALLUSHI	7437	304
Elbasan		6000	5550
Lezhë	Preng Dedë Muça		0
Korçë		745	90
Korçë	Irfan Qose	11468	532
Durrës			0
Fier	Vasillaq Gjini	4150	5149
Tiranë	ZIJA SHABA	5658	8151
Korçë		500	11150
Korçë	Hajdar Lulo	1165	434
Korçë		816	1200
Lezhë	Gjin Ndue Trokthi	2880	18785
Kukës	Agim Mulaj		11990.8
Durrës		5000	77120
Korçë		24	686
Elbasan	GANI GRIPSHI	2700	300
Elbasan	DERGUT ÇEKA	9500	300
Elbasan	MEHMET KAZIU		0
Elbasan	HEKURAN TOSKU		0
Tiranë	Shyqyri Piciri	5404	256
Durrës			250
Elbasan	HEDIJE KAÇULI	5000	8270
Durrës		1959	8424
Tiranë			0
Korçë			8674
Korçë		3432	7133
Vlorë		1562	2038
Fier	Ali Lloshi	500	9500
Gjirokastrë	Gjergjo Marku	3400	300
Gjirokastrë	Vangjel Guzhuni	2800	600
Shkodër	Makbule Shabani	108	250
Tiranë	GEZIM VASKU	338	119
Vlorë	Vendigar Hamzaraj	10000	5000
Fier	Beqo Brahimaj	4350	820
Elbasan	HEDIJE BAKALLI	14861.45	2697.05
Korçë		310	323
Elbasan	NADIRE ULLORJA		0
Korçë		2235	3823
Vlorë	Shemo Qerimi	699	659
Fier		668	920
Korçë			4207
Vlorë	Anest Dhimojani	1130	8740
Korçë			299
Korçë			56
Korçë	Anesti prifti		0
Durrës		374	15274
Korçë		174.27	692.89
Korçë			263
Durrës		110	0
Durrës	Sotiraq Shyti		0
Durrës		164	98
Elbasan	JALLDYZ DYLGJERI	100	156
Vlorë		7500	
Tiranë	Lirika Metani	2326	9166
Vlorë	Vitori Dhimitri	1554	600
Vlorë	Urania Dhimitri	2275	2200
Fier	Jashar Muço	3960	540
Tiranë			227
Elbasan	SADIK VRIONI	1975	3625
Dibër	VELI KOLA	21232	31744
Shkodër	Trash. Kronaj	4326	520
Vlorë	Lluka zano	5000	4100
Durrës		1000	3935
Durrës		5000	600
Vlorë	Anastas Pando	3066	1234
Durrës		3800	4200
Durrës		1900	6100
Durrës		3150	4850
Durrës		1900	6100
Elbasan	MARJETA TABAKU	182	120
Korçë	Sali Hamzaj	6677	3506
Vlorë	Mangjar Veshi	700	220
Elbasan	HIMI SHENGJERGJI	2454	15
Lezhë	Gjin Zef Gjini		2430
Korçë			3985
Shkodër	Vullnet Ademi		192
Korçë	Shaban Avdyl Agolli		938
Korçë			105
Korçë	Ylber Merdani		180
Vlorë	Tomson Godo	3965	1771
Korçë			0
Korçë	Ylli Starova	1693	982
Lezhë	Zan Tirana dhe 4 trashëgimtarë të tij	4354	9646
Kukës	Sali Shaban Gjyriqi	11078.7	10301.6
Vlorë	Evrldhiqi Kokaveshi		140
Vlorë	Maten Hamza	2500	1500
Korçë		356	725
Korçë	Bardhyl Frashëri	3684	523
Korçë	Theodhoraq Nasto		42.82
Durrës			572
Durrës		4250	2350
Durrës		1695.39	10570.61
Korçë		208	2962
Korçë	Kreshnik Zgjani		666
Fier	Myrteza Kapllani		9090
Gjirokastrë	Simon Ballabani	108	416
Durrës			188.6
Durrës			6398
Lezhë	Nikoll Dod Krusi		0
Durrës		2400	1600
Fier	Klemend Lutaj	5740	5000
Fier	Muhedin Lutaj	4225	300
Lezhë	Ndue Gjin Ndoka	838.81	13579
Fier	Ali Roshi	800	9200
Korçë		556	1180
Durrës		5000	1000
Tiranë	MERSIN LOCKA	11161	1239
Tiranë	GANI GJUZI	764	9218
Tiranë	HALIT, LULZIM BRAHJA	4470	4321.5
Tiranë	HERRI	26080	1676
Korçë			7194
Durrës	Kandila Bozo	266	2127
Durrës	Nikolla Felahi	540	4500
Elbasan	AHMET BYLYKU	190	510

Durrës		175	215
Korçë	Muhammed Faqëzezi	2968	153
Elbasan	BAJRAM DOCI	3000	5000
Fier	Novruz hoxha		29240
Fier	Ahmet Orizaj		6260
Fier	Shpresa Ganaj		927.5
Shkodër	Berhan Ulqinaku	3910	1444
Durrës		10091	1351
Durrës		121	308
Korçë		3030	290
Elbasan	SHKENDIE SEJDINI	2640	7960
Lezhë	Preng Geg Jaku	6577	932
Durrës		5000	400
Vlorë	Spiro zisi	545	2535
Fier	Hava Bejte		0
Vlorë	Thanas	200	1192
Gjirokastër	Hasan Bejko	1964	170
Vlorë	Resul Shino		0
Vlorë	Bilbil Labaj		1486

Vlorë	Milto Bollano	2105	0
Elbasan	DYLBERE FLOQI		24
Elbasan	XHEMAL SALLA	560	2370
Fier	Suzana Agaraj	52	449
Shkodër	Fatlum Nurja	493	300
Lezhë	Nok Gjet Mhilli	104.3	5270.7
Durrës		132	2204
Durrës		3472	528
Tiranë		5000	2000
Elbasan	SHPRESA T OSKU		240
Tiranë	ASLLAN PICARI		13100
Korçë		1070	108
Korçë	Skender Shkemi		6840
Korçë	Llazi Nako	225	2592
Korçë	Shendet Shtylla		1600
Korçë	Guri Nuni	6110	3732
Elbasan	STAVRI BARDHI	180	180
Tiranë	SAMI BESHKU	25440	134560
Fier	Cen Musai		5856
Fier	Simon Ndoni		0
Korçë	Llambi, Dhimiter Kcyku	404	10300
Vlorë	Agush Pashaj	2400	800
Fier	Ibrahim Likja		
Korçë	Vasillaq Vangjeli	122	126
Korçë			2645.6
Durrës	Erik Shehu	157.5	0
Durrës			1000

Elbasan	BARDHYL MIRAKU	1200	610
Gjirokastër	Agron Ismaili		2581
Korçë		1748	1791
Korçë		855	2115
Korçë	Minir Xhemal Pengu	1600	1370
Fier	Guri Sefa	2367	1480
Durrës			332.75
Shkodër	Sami Anamali		130
Tiranë	Mehmet Gjuzi		18220
Fier	Dervish thana	2000	0
Fier	Manir pepa	4100	400
Fier	Selim Xhelo		1000
Durrës	Fatmira T aga		0
Fier	Tafil Mebelli		5000
Durrës	Mexhit Kalaja	1060	3568
Durrës	Seid Lama		227
Durrës	Fatmir Kupi		3690
Tiranë	GEZIM DERHEMI	3900	28100
Tiranë	GAJDA TOPTANI		11000
Tiranë	HAJRIE DERHEMI		12000
Korçë	Guri Kondi	2431	1769
Fier	Islam Jazaj		1240

Korçë	Vasilika Bozo		125
Korçë	Niko Panolli		47.6
Korçë		85	59
Durrës		5000	6800
Dibër	SAZAN DINE		0
Korçë		700	10636
Korçë		400	12632
Tiranë	KELMEND REXHA	465.5	88.5

Tiranë	Zhaneta Uka	2785.5	4194.7
Dibër	FEHMI MIKLI		0
Lezhë		199	4870
Korçë			1000
Durrës		198.5	145.2
Vlorë	Dhimiter Kardhashi	1500	1400
Fier	Vathe Lika	2000	5800
Elbasan		4370	0
Elbasan	NIKOLL HAXHILLAZI	226	380
Korçë		68.6	787.9
Durrës	Ruzhdi Cara		4545
Durrës		4644	4150
Kukës	Naim Mustafaj		4873
Durrës	Ramiz Deliallisi	10000	900
Korçë		600	162
Korçë			157.5
Korçë			800
Dibër	SAZAN DINE	3620	2410
Dibër	SAZAN DINE	4455	1545
Korçë		338	681
Durrës			638
Fier	Nexhip Vrenozi	2706.5	2729
Fier	Kiu Moçi		10340
Fier	Rrahman Uruci	2154	1400
Gjirokastër	Mihal Piperi	1547	2350
Elbasan	MIHAL PAPANUSI	940	673
Lezhë	Gjon Pali		5500

Tiranë	QAZIM BALLA	2200	1800
Tiranë		5000	2500
Fier	Bajram Kuka		5620
Korçë			600
Korçë	Sazan Ramadan Abrashi	4688	1467
Korçë	Engjellush Lari	194	3816
Korçë		816	1500
Durrës	Vjollca Tafaj		0
Durrës		1186	1010
Korçë	Sulejman Staro		300
Durrës	Bardhyl Guni		0
Durrës	Hamid Guni	226	420
Tiranë	HASAN, MALIQ DHE MUSTAFA LALI	10334	3886.6
Tiranë	ALI ARBANA	982.5	7999
Tiranë		198	21.6
Tiranë	HYSNI REKA	6049	5451
Durrës		10005	560
Elbasan	NUKOLLA BULLGARI	526.2	1373.8
Vlorë	Esma Hasani	1500	260
Vlorë	Namik Taipi	554	170
Elbasan	JORGJI PANARITI	108	527
Elbasan		3815	5712
Elbasan	IBRAHIM GRADA		212
Kukës	Bajram Selim Mustafa	2993	0
Durrës		2470	2874
Durrës		5450	5119
Fier	Llambi Lipe		690

Vlorë	Mario Rexho		0
Fier	Zylyftar Dervishi	5000	5040
Tiranë	PETRO KARABLINA	1267	140.5
Fier	Shqere Rakipaj	2887	5866
Durrës	Hamdi Topi	750	5166



Durrës		8769	2463
Korçë	Emin Beqiraj	1920	2000
Korçë	Tefik Qeraxhi	9059	997
Durrës	Elisabeta Kokomani	5826	63843
Tiranë	MUHARREM STERMASI		197.6
Elbasan	TRASHKIM TARKETI & ALI ZEKRI ZEKRI		3809
Korçë			34
Korçë		2129	970
Tiranë	MUHARREM STERMASI		253.4
Tiranë	MITAT, ESAT DEMIRI	2135.84	2904.9
Fier	Azbi Cela		1000
Vlorë	Cano Bonjaku	800	400
Vlorë	Hava Hajdini	4500	0
Vlorë	Nuri Sharra		0
Shkodër	Zyber Kuka	1308	306
Lezhë	Ded Frrok Cungu		557
Korçë		9100	1110
Korçë		6255	4045
Korçë			140
Korçë		596	300
Elbasan	ELIZABETA KULLOLLI	250	735
Elbasan	VELI SHAQIR ÇELA, CELA	1010	1990
Gjirokastër	Mejreme Karalliu	2590	7237
Shkodër	Ibrahim Cungu, Nikolla Beroviç	10074	0
Dibër	BAJRAM DISHA		1212
Elbasan	SHPETIM ENVER KAHREMANI	130	30
Vlorë	Qatip Malaj		0
Vlorë		2042	583
Gjirokastër	Foto Lici	1500	500
Korçë	Demirali Biba	448	672
Durrës		16527	9063
Elbasan	ARQILE KELA		132
Shkodër	Giuseppe Lanza	2609	0
Vlorë	Hasan Nivica	1110	68
Fier	Qemal Saliaj	4126	1880
Korçë			0
Durrës			400
Durrës			1600
Durrës			30000
Durrës			116000
Elbasan	DASHAMIR GEGA		28
Elbasan	QAMIL SKUQI	45	386
Kukës	Agim Mustafa		0
Kukës	Azem Hoxha (Gjocaj)		0
Kukës	Kadri Sokol Mustafaj	2675	15251
Kukës	Nadire Mustafaj	9226	5000
Vlorë	Myzafer Bazaiti	350	190
Vlorë	Enver Isufi	2253	1180
Vlorë	Violanda Ceco	300	1420
Durrës		4149	2593
Durrës		4500	4210
Vlorë	Loli Nase		0
Tiranë	HASAN FARKA	6857.2	3944.5
Tiranë	SULEJMAN HOXHA		15827
Gjirokastër	Ali Sino	4384	510
Durrës		2725	3962
Shkodër	Injac Kabashi	660	62
Shkodër	Qemal Caku	540	55
Fier	Bajram Koreshti	1025	2375
Elbasan	QAZIM KUQASHI		0
Shkodër	Fejzi Kopliku	310	835
Fier	Vilhem Veizaj		10220
Korçë			0
Tiranë	Haxhi Rradhesi	780	262
Tiranë	ISMAIL VATHI	3720	5127
Dibër	LUAN VRANICI		789
Tiranë	REXHEP PICARI	5337	2142
Tiranë	IDRIZ MUÇA IDRIZ	7173	5190
Tiranë	ARTAN NISHKU	1933	808
Tiranë	GAJDA TOPTANI	22800	4276
Korçë	Niko Llazi Kole		0
Korçë	Myrvet Duro	226	600
Durrës		451	3319
Durrës		2500	7818
Vlorë	Dehar Muzhaj	3058	450
Vlorë	Jani Raku		300
Korçë	Vasil Orgocka		1020
Durrës		1700	2714
Durrës		4590	618
Shkodër	Mirjam Peçi		0
Tiranë	BUKURIE ALICO	5364	7025
Gjirokastër	Qemal Nora	1350	900
Gjirokastër	Musa Nora	1350	900
Gjirokastër	Nazif Alikaj	480	170
Elbasan	DHIMITRA KANANI	80	114
Elbasan	GEZIM MEÇE	110	190
Elbasan	AGIM MEMA	1510	560
Lezhë	Bardhyl Hoxha	149	1726
Vlorë	Mete Kadria	398	3970
Vlorë	Pavlo Çika	23430	6655
Korçë	Ramie Qamil Pashollari		6650
Korçë	Bahrije Terolli		5834
Lezhë	Gjok Pashk Lleshi		1125
Korçë		615	283
Durrës			4292
Elbasan	HASAN PALLUQI		15
Shkodër	Trash. Pacaj	5200	2613
Lezhë	Pellazg Fusha		10079.4
Durrës			5900
Durrës			518
Durrës	Hariklia Tico		1500
Korçë		2787	1616
Shkodër	Faik Luli	68	74
Durrës		32	10102
Korçë	Sefer Lumani	138	1964
Gjirokastër	Vasilqi Budali	2122	272
Vlorë	Feti Licaj	290	60
Kukës	Zeqir Iusf Hasanpapaj		1130
Vlorë		5000	5300
Durrës	Hamid Taga		700
Durrës	Hajdar Baruni		300
Durrës	Zanun Vogli		300
Tiranë	LIRIM DOBI	26.8	18.4
Elbasan	SHEFQET SERJANI	270	296
Durrës	Muharrem Hoxha		280
Durrës		9709	3440
Fier	Astrit Lula		397
Fier	Trashëgimtaret		3214
Fier	Trashëgimtaret		9025
Shkodër	Prek Bushati		0
Tiranë	Hamit Karaboja		833
Gjirokastër	Sotir Beruka	410	4
Shkodër	Salvator Ndoja	161	513
Durrës	Kico Dumi		567
Shkodër	Ibrahim Cungu, Nikolla Beroviç		0
Gjirokastër	Kono Daka	1500	450
Gjirokastër	Besim Merko	3555	2200
Elbasan	FATIME ÇAKULLI	115	70
Durrës	Rifat Bardhi		300
Vlorë	Anastas gurra	1290	1160
Korçë	Xhevo Lumani	1813	495
Durrës	Vjollca Qatipi		244
Gjirokastër	Minella Pasko	100	300
Korçë	Valter Dilka		10990
Korçë	Niko Pepa		723.65

(vijon)

## BOTIMI

E ka provuar mbi kurriz hakërrimin komunist që në vitet '40, ka njohur gjyqin, burgun, riedukimin dhe teksta stilolapsi shkruan vargjet e ndaluara burri i moshuar që e shkoi jetën nën presion, flet fjalët e vetme të lirisë. Janë poetët më në zë të përtejdetit

# ZEF ZORBA

## Trinia e shenjtë e poetëve të ndaluar në fletoret e harruara të 1980-ës

*Poezitë e tre nobelistëve në letërsinë e sirtarit dhe një vit punë që të dalin në dritë*

Fatmira Nikolli

Ajo që dinit ju për mua s'qe tjetër gjë veç shërbetose, ajo gunë që mbështjell shortin tonë njerëzor. E mbase coha ishte kthjellimi i qetë; pengonte qiellin e kulluar vetëm e vetëm një vulë miratimi. O mbase ish ndërrimi përçudë i jetës sime, zbrërthimi i një plisi gacë që kurrë më s'do ta sodis. Kësisoj kjo lëvore mbeti brumi im i njëmendët; zjarri që s'do të fashitet u quajt për mua: mospërfillje. Po qe se vreni një hije, s'është hije - ajo jam unë. Prej vetës kesh ta shkujla e për dhuratë t'jua jepja.

**(Eugenio Montale, shqip nga Zef Zorba)**

Mbramje, Shkodër, vitet 1980. Qyteti i është dorëzuar natës, mbasi më herët i është dorëzuar frikës nga regjimi.

Zef Zorba ka ndez kandilin dhe mbi tavolinën e vogël prej druri pothuaj i strukun në dhomën e tij, u jep zë shqip poetëve "hermetikë" italianë. I fshihet botës së jashtme sepse e di që në pushtetin e kohës, shijet e tija letrare janë "herezi". E ka provuar mbi kurriz hakërrimin komunist që në vitet '40, ka njohur gjyqin, burgun, riedukimin dhe teksta stilolapsi shkruan vargjet e ndaluara burri i moshuar që e shkoi jetën nën presion, flet fjalët e vetme të lirisë. Janë poetët më në zë të përtejdetit, dhe ai merr prej tyre poezitë që e prekin më së shumti, poezitë që i flasin më së shumti, duke nxjerrë prej vargjeve gjithë çfarë kyçet në hermetizimin e autorëve.

Ka punuar me vite dhe disa prej poezive nuk kanë datë. Gjenden në fletore të zverdhura, me një shkrim të pjerrët, të ruajtura fshehurazi. Rreth një vit më parë vajzat e poetit ia dorëzuan fletoret e të atit Anna Shkrelii nga shtëpia Botuese "Çabej". 100 poezitë e tij, të përkthyer nga netëve e ditëve të gjata, erdhën në shqip veçse prej dëshirës e shijes së mirë të Zorbës. Nuk qe menduar atë kohë se do ta shihnin ndonjëherë dritën. Nuk qe menduar se do të mbërrinin deri



te lexuesi. "Mendohet se i ka përfunduar diku në vitet 1980. Nga teksti ndjehet që i ka lëmuar për shumë vite. Rreth njëqind poezi të tre poetëve të mëdhenj italianë të shekullit XX, Eugenio Montale, Salvatore Quasimodo dhe Giuseppe Ungaretti vijnë në shqip të përzgjedhura dhe shqipëruara nga poeti i njohur shkodoran Zef Zorba, njohës e admirues i të treve.

Deri tani i kanë ruajtur si dorëshkrim fletore të bijat. Ne i kemi marrë një vit më parë por duke qenë se janë tre poetë nobelistë në të tyre në shqip. Sepse Zorba ka marrë poezitë e tyre më të mirë dhe marrja e të drejtave ekskluzive të botimit është një proces i gjatë", tha Anna Shkrelii për "Gazeta Shqiptare".

Pas një viti e gjysmë punë me to, poezitë janë gati dhe botohen nën titullin "Montale, Quasimodo, Ungaretti. Perfectum Trinum - Antologji Poetike".

Gjatë procesit të përgatitjes së librit, është ruajtur pothuajse

dorëshkrim nga Zef Zorba. Poezitë i paraprin një parathënie e shqipëruarit, ku ai vë në dukje rëndësinë e udhës që ata do të gëlin për letërsinë moderne europiane. Të mbetura në dorëshkrim për disa dekada rresht ato po shohin dritën e botimit, në një libër dygjuhësh, me tekstin shqip e italisht përmbri - mënyra ideale për të shijuar poezinë e përkthyer.

Se pse këto poezi dalin vetëm tani nga letërsia e sirtarëve na e tregon vetë jeta e Zorbës. I lindur më 1920-ën në Mal të zi në një familje shqiptarësh, Zefi pas mbarimit të gjimnazit në Shkodër, shkoi në Padova për studime më 1941. Dy vite më vonë e ndërpret shkollën për shkak të luftës. Me fillimin e instalimit të regjimit, është regjisor në Shtëpinë e Kulturës së Shkodrës, ku vë në skenë mjaft pjesë dramatike me tingëllim të qartë desident si "Juda Makabe" e Fishtës, "Armiku i Popullit" i Ibsenit etj. më 1946 arrestohet me akuzën e agjitacionit e propagandës. Vuan dënimin ndër kampet e punës dhe "riedukimit" deri në vitin 1951. Më vonë punon në ndërmarrje të rrethit të Shkodrës si llogaritar deri në vitin 1980, kur dhe del në pension. Nderroi jetë në janar 1993 në Shkodër.

### DY FJALË NGA SHQIPËRUESI

Paralelizimi i këtyre tre poetëve të mëdhenj mendoj se mund të pasqyrojë zhvillimin e poezisë në Itali gjatë këtij shekulli. Sintetizimi vetëm në këta të tre sigurisht as i errëson e as i mënjanon poetët e tjerë me peshë, siç janë U. Saba, M. Luzi, V. Car-darelli, V. Sereni, P. P. Pasolini e dhjetëra të tjerë që jehojnë fort me individualitetet e veta të shkëlqyeshme. Drejt zgjedhjes së këtij triptiku nuk më shtyu gjykimi i Akademisë së Suedisë, që nderon Quasimodon e Montalen me çmimin Nobel e që ka pasë menduar të njëjtin çmim edhe për Ungarettin.

Për këtë përmbledhje më kanë shtyrë kryesisht të tjera konsiderata, e sidomos koha e veprimtarisë së tyre, që nis thuhetë në herit (1915-1922), si dhe përpjekja e tyre e përbashkët për ripërtëritjen e poezisë në këndvështrim modern.

Shqipëruarit i këtyre vargjeve ka pasur rast të njihet që para 50 vjetësh me krijimet e tyre të para, pra në një kohë kur kritika kon-

servatore dhe ajo e regjimit më fort e denigronte sesa e përkrahte poezinë moderne në tërësi, në rast se nuk e injoronte krejt. Sulmet e para konservatore e reaksionare u drejtuan kundër Ungarettit, kryesisht për shkak të një nga botimeve të tij të para Porti i varrosur në 1916. Thotë Ungaretti vetë: "Botimi i Sentimento del tempo (Ndjenja e kohës) sikundër botimi i pjesës së parë të Allegria (Gazmend), po edhe Porto sepolto (Port i varrosur), janë pritur me kritika të çuditshme. Madje në të dyja rastet jam "nderuar" gjer me krijimin e revistave letrare thuhetë vetëm e vetëm për të më luftuar."

Jo shumë i ndryshëm ka qenë qëndrimi i kritikës ndaj Montales e Quasimodos, megjithë që më pak shpohitës, për shkak se fishkëkët po harxhoheshin të gjithë kundër Ungarettit duke pandehur se me "vrasjen" e këtij do të vritej "hermetizmi" i përçafuar nga të tre. Gjithashtu krijimet e para të Quasimodos e të Montales, ndonëse "hermetike" e "esencialiste", dukej sikur nuk binin në kundërshtim të hapur me traditën.

Kjo antologji është e pamjaf-tueshme për pasqyrimin e veprës poetike të të treve apo për paralelizimin e tyre, pasi veç së vërtetës "traduttore-traditore", edhe vetë metoda e antologjizimit është dash-të e pa dash-të vullnet i përzgjedhësit e njëfarë shkandje-je e veprës totale të autorit. Nga fraksionarizimi ka rrezik që "poeti-njeri" të paraqitet me reflekshe jo të qenësishme nga e gjithë pro-dhimitaria e tij. E mbara do të ish-te të jepej shqipërimi i plotë i ve-prës poetike të çdonjërit. Po kujt ia mban? Mua jo. Megjithëse të tre cilësohen me titullin përmbledhës "poetë lirikë", po të bazoheshim më fort në rrymën dhe formimin e secilit, do të quheshin vetëm "poetë". Kjo pasi qdo libër i tyre ka një organicitet rigoroz. S'mund të veqohen pjesë pa cenuar integri-tetin e veprës, dramës, afreskut a simfonisë. Librat e tyre s'janë një përmbledhje e thjeshtë poezish, por një vepër e plotë në vështrimin e mirëfillt aristotelian. Thotë Un-garetti për librin Allegria: "Ky libër s'është veçse një ditar. Autori nuk ka ndonjë ambicje tjetër dhe beson se edhe poetët e mëdhenj s'kanë pasur pikësynim të ndry-shëm, posë që të linin një biografi

kudo dëshira e mbrame e shqipëruarit. Duke qenë se ai nuk jeton më, është parë me vend të mos ndërhyhet te përkthimet, në mos është dashur të bëhen njehsime, por parësore ka qenë ruajtja sa më shumë e originalit të lënë në



## PREMIERA

# "Antigona" në "Eksperimental", një heroinë që kundërshton

Fatmira Nikolli

Regjisorja: Të gjithë ne kemi brenda vetes një Antigone

të bukur të vetën".

Prandaj edhe librat e tyre mbajnë që në titull këtë karakteristike ditari. Klasifikimi i veprave poetike të këtyre poetëve s'është i thjeshtë. Rruga e revolucionit artistik i ka çuar ata në zbulimin e metodës "hermetike" ose "esencialiste" të thelluar deri te fjala, rrokja, pauza.

Kritiku A. Gargiulo thotë: "Duket sikur fjalës i është kthyer virgjëria fillestare... Hyjnë në fuqi vlerat e ritmeve, pauzave e ndoshta më shumë vlerat fonike 'evokuese'...". E tillë ka qenë aspirata e artit të ri, e "esprit moderne": me fuqizue shprehjen poetike duke e zhveshur nga superstrukturat që po e mbysnin; poezia si shprehje artistike e "homo sapiens" duhej çliruar prej mërtyshesh të verbalizimit të një rutine të pezmatuar. Burizantë të kësaj domosdoshmërie, që në shekullin e kaluar, u bënë Lamartine e De Vigny, Leopardi e Pascoli, Heine e Rilke, Shelley e Byron etj. Ai kushtrim i kap shpejt e kryekrejtë në Francë: Beaudelaire e Verlaine në poezi, Degas e Renoir në pikturë, Debussy e Strauss në muzikë. Në vazhdim të vërshimit mori dhenë: Mallarmé e Rimbaud, Picasso, Stravinski e qindra të tjerë. U shfaqën rryma e shkolla të reja, Futurizëm e Kubizëm, Psikanalizë e Ekzistencializëm, muzikë khax e dodekafonike. U qëmtua çdo fushë me zhdivillime marramendëse e ndonjëherë, medet, edhe me anarkizma të çmendura. U mobilizuan talente novatorë, artistë që hiqnin zor, por qëlloi që me rrymat e vrullshme u përzenë edhe mitomanë, snobë, intelektualoidë, qyrravecë. Për shkak të tyre në mjaft raste u vështirësua dallimi i gurëve vërtet të çmuar e sidomos iu hap goja konservatorëve, të cilët duke u mbështetur në të tilla shfaqje sporadike gjetën rastin të hidhnin helm mbi tërë artin modern. Koha dhe historia i fshinë kërpuhat që i mbënë modernizmit, duke i detyruar kritikët mallkues të reshtnin zërat e tyre përcmues.

Kështu u zhvillua e më vonë u fashit kritika ndaj hermetizimit. Sot poetët e kësaj rryme kanë hyrë në tekstet shkollore, janë bërë objekt studimesh të thelluara dhe veprat e tyre botohen, ribotohen e përkthehen në gjuhë të ndryshme. Gjysmë shekulli më parë mjaft studiues shfaqnin dyshime rreth qëndrueshmërisë së poezisë moderne. Duke marrë shkak nga tipari dekadent i saj, nga parazitizmi që po i zhvillohej përreth e nga njëfarë rënije të përkohshme që sollën zhgënjimet e Luftës së Parë, veçanërisht për Italinë, disa kritikë shpallën me solemnitë fundin e modernizmit në poezi. Paçka gjithë parashikimeve mortore të tyre, arti modern u estetizua, u konkretizua e u përhap gjerësisht. Këtë u detyruan ta pranonë edhe kritikë me peshë, si Francesco Flora i cili deklaroi: "Megjithatë poezia esenciale hermetike o sido të quhet i pëlqen lexuesit modern". Në mbrojtje të poezisë moderne u ngritën studiues e filozofë të ndryshëm. Benedetto Croce sintetizoi: "Për poezinë, zërrja ekziston". Kështu lulëzuan kalibra të rinj poetësh. Tani arti modern s'ishte më një zë në shkretëtirë, një mirazh, porse realiteti sublim i pamohueshëm.

Jam e apasionuar me Antigonën e Jean Anouilh, sepse kjo heroine e kontemporane përcjell mesazhe që i kalojnë kufijtë. Është historia e një vajze të re që thotë Jo, që kundërshton. Ajo thotë atë që mendon, dhe kjo liri e të shprehurit do t'i kushtoj jetën, një jetë që nuk ia vlen ta jetojë ndryshe. Përballë Antigonës edhe më i fuqishmi bëhet i dobët sepse e vetmja që nuk e bëjmë dot është të detyrojmë dikë të jetojë. Unë besoj se të gjithë ne kemi brenda vetes një Antigone, e cila kur zgjohet na inkurajon të bëjmë zgjedhje radikale".

Regjisorja Andrea Brusque e zbrthen në këtë mënyrë personazhin e "Antigonës" nga Jean Anouilh.


Për të, ky konflikt, konflikti midis tiranit dhe revolucionarit është diçka që na prek thellësisht pasi ka të bëjë me të gjithë ne.

"Jean Anouilh luan mrekullisht me kodet e tragjedisë. Me humor dhe me distancë ai të kujton se të gjithë personazhet do të vdes-



in dhe kjo është e pashmangshme, por lajmi i mirë është që ne, spektatorët, jemi gjallë, ndaj ka ende shpresë", thotë Brusque.

Shfaqja që vjen premierë këtë fundjavë te Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", është një përshatje e tragjedisë së Sofoklit me të njëjtin titull. E përkthyer nga Ekrem Basha, me skenografi të Beqo Nanaj dhe aktorët Laura Nezha, Ervin Bejleri, Romir Zalla,



Xhino Musollari, Xhulia Musagalliu, Adriana Tolka, Endri Cela, Klejdi Metaj pjesa është një prej atyre që kanë shumë mesazhe për ditët tona.

Aktorja Laura Nezha tha dhe para mediave se shfaqja e ka bërë të dashurohet. "Jam me fat, që më është besuar ky rol. Antigona më ka bërë të dashurohem pas saj, për disa elementë të çiltërisë dhe pastërtisë, që them se duhet ruajtur, se janë

vlera shumë njerëzore, të shoqërisë e aq më tepër shqiptare. Që në momentin që ajo kundërshton, më ka bërë për vete, sepse nuk do që të bëjë kompromise. Më ka bërë për vete kjo heroinë e kohëve moderne", tha ajo.

Vepra nën regjinë e Andrea Brusque, duke trajtuar tema si tragjedia, idealizmi i rinisë, kompromiset e moshës madhore, dueli mes moralit dhe politikës, si edhe zgjedhjet dhe paqartësitë e jetës në një botë komplekse.

"Gjithmonë kam menduar se teatri është politik, edhe kjo veprë është një veprë politike. Kam menduar që është politik, se ka fuqinë që t'i bëjë njerëzit të mendojnë, kjo veprë bëjmë të njëjtin gjë, sepse personazhet që luajnë në këtë veprë, ne mund ta takojmë edhe në media. Kreoni bën vajtje-ardhje nëpër botë, përhap fjalën e mirë për Tebën. Antigona e kemi sa herë mbledhet parlamenti në protestë. Më pëlqen që teatri të jetë goditës dhe interaktiv, sepse një shfaqje ku publiku del pa shkëmbyer një fjalë pasi e sheh për mua nuk ka kuptim", tha aktori Ervin Bejleri që mban një tjetër rol të rëndësishëm.

Tragjedia "Antigona" ngjitet këtë fundjavë në skenën e Teatrit të Eksperimentalit. Interpretimet e aktorëve: Laura Nezha, Ervin Bejleri, Romir Zalla, Xhino Musollari, Xhulia Musagalliu, Adriana Tolka, Endri Cela dhe Klejdi Metaj.

## PJESJA

E shkruar në vitin 1942, kur trupat naziste pushtuan Francën, historia sillet rreth konfliktit të Antigones idealiste dhe xhaxhait të saj të ngurtë, Kreonit, në lidhje me varrimin e vëllait të Antigones, Poliniku. Gjithashtu vepra u interpretua se përfaqëonte luftën e lëvizjes së Rezistencës franceze kundër forcave të qeverisë Vishi? gjatë kullimit të pushtimit nazist.

Varianti i Anuil i Antigones prek tema si tragjedia, meta-teatri, idealizmi i rinisë, kompromiset e moshës madhore, dueli mes moralit dhe politikës, si edhe zgjedhjet dhe paqartësitë e jetës në një botë komplekse jo bardhë e zi.

Antigona është njëra nga seria e pjesëve dramatike të Anuil, që kanë si bazë mitologjinë greke. I zhgënjyer dhe i tronditur nga ngjarjet e Luftës II Botërore, ai shkroi gjithashtu Euridika (1942) dhe Medea (se pari e vënë në skenë në 1937 dhe e botuar në 1946), të cilat ishin gjithashtu variante të përshatatura të klasikeve origjinale greke. Këto vepra eksplorojnë rolin e fatit në jetë e njerëzve.

E vlerësuar shpesh si kryevepra e tij, Antigona çmtoi reputacionin e Anuil si autor dramatik. Vepra që sukses i menjëhershëm, kur u vu në skenë së pari në Paris në vitin 1944.

Zhan Anuil (1910 - 1987) ishte autor dramatik, teoricien, kritik dhe shkruante për film e televizion. Ai interesohet për rolin e individit në shoqëri dhe përplasjen mes idealizmit dhe realizmit brenda individit.

## "FESTIVALI NDERKOMBETARI FILMIT TE GRUAS" NË TIRANË

Që një mesazh sensibilizues të perceptohet duhet të gjejsh momentin e duhur kur ta bësh pjesë të vëmendjes publike. Tema e trajtimit të gruas u bë kohët e fundit pjesë e debatit publik shumë të animuar në media. FESTIVALI NDERKOMBETARI I FILMIT TE GRUAS (WOMEN INTERNATIONAL FILM FESTIVAL) vjen këtë 8 Mars si kontribut në këtë debat por me një gjuhë të re, me gjuhën e filmit dhe e freskon, e pasuron, dhe e thellon këtë debat. Kryetari i Qendrës Kinematografike të Filmit në Tiranë, Ilir Butka, thotë se kinematografia ka aftësinë e gjenitimit të një impakti të fortë emocional ndaj ne duhet ta shfrytëzojmë në dhënien e mesazheve nëpërmjet këtij instrumenti të fuqishëm i cili ka privilegjin të shtresëzohet më pas si pjesë e koshtencës dhe kul-



turës kolektive të shoqërisë. Sipas Butkës, duhet ta konsiderojmë audiovizualin në përgjithësi dhe kinematografinë në veçanti jo vetëm si formë të shprehjes artistike, por edhe si një instrument të fortë në shërbim të formimit dhe edukimit shoqëror.

"Përgëzimet më të mira për partnerët tanë që e kanë ideoar dhe i dhanë jetë këtij eventi të rëndësishëm me të cilin shpresojmë të

sensibilizojmë publikun por edhe artistët, krijuesit, skenaristët, regjisorët tanë në inkurajimin e trajtimit të tematikave të tilla të cilat mund të ndihmojnë në gjetjen e interesit të audiencës ndaj prodhimeve audiovizuale në përgjithësi dhe filmave tanë në veçanti", thotë kryetari i QKK-së. Ai shton se ka shpresë që institucionet e vendit dhe të huaja që vepronin në ndihmë dhe në nxitje të prodhimeve audiovizuale, filma të shkurtër, dokumentare, animacion etj., që mund të targetojnë grupe dhe kategori të formimeve dhe moshave të ndryshme të shoqërisë, në përcjelljen e mesazheve të tilla.

Opinion i Ditës

# Telat me gjemba dhe dhuna e trembur

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... i vështirë dhuna ndaj deputetëve apo pushtimi i Kuvendit. Kjo shkurajoi çdo mendje të nxehtë protestuese që e kishte llogaritur dëmtimin e pronës publike dhe shkatërrime në objekte shtetërore të rëndësishme së veçantë, një biznes të lehtë për t'u kryer. Shenjat e para u dukën ditën e 16 shkurtit, kur pas xhamave të thyer të hollit të katit të parë të kryeministrit, trupa të motivuara dhe të qeta ishin gati të përballonin mësymësit e revoltuar, për të mos i lënë të depëronin në atë ndërtesë. E gjitha kjo është meritë e Policisë së Shtetit, që më në fund, pas gati 28 vitesh provash jo profesionale, di të organizohet si duhet dhe arrin të përballojë turma të revoltuara, madje edhe të shuajë që në lindje çdo tentativë për shkatërrim. Më në fund kemi segmente shtetërore që nuk gjenden të papërgatitura nga të papriturat e një proteste. Ndërkohë, tek shumë qytetarë të këtij vendi, dy ditë më parë pritja për protestën e opozitës përpara dyerve të Kuvendit ishte e mbarur me shqetësim. Madje, për disa, gati-gati me frikë. Shqetësimin dhe pritjen e tensionuar e kishte rritur ndjeshëm paralajmërimi një ditë më parë i ambasadës amerikane në Shqipëri që qytetarë të SHBA-ve në Tiranë të mos ndodheshin pranë mjediseve të Kuvendit në kohën kur do të zhvillohej protesta. Një paralajmërim i tillë nuk ishte bërë ditën e 15 shkurtit, një ditë më parë protestës së madhe përpara kryemi-



nistrisë. Dhe njerëzit i nxirrnin vetë konkluzionet. Pritej diçka jo e mirë për vendin. Për fat, protesta kaloi pothuajse paqësore dhe për këtë meritë i takon, krahas kësaj policie tashmë profesionale në detyrën e saj, edhe opozitës. Po, po. Kësaj opozite sot të vetëlarguar nga skena normale politike. Të anatemuar keqazi, të nëpërkëmbur, të injoruar. Që ka shumë komplekse brenda vetes, por që gjeti forcën, edhe në momente tejet të vështira për të, që

të mos nxisë akte dhune. Të përmbyjë më të ekzaltuarit dhe trazovaçët mes protestuesve. Ky është një shërbim i madh për vendin, nga çdo anë ta shohësh. Gjuha mund të jetë e rëndë, provokuese. Por provokime reale ndaj trupave të rendit që mbrojnë Kuvendin nuk pati. Mos vallë thjesht nga një polici shumë më kompakte dhe e qëndrueshme, u trembën skifterët më të papërmbyjtur të opozitës? Mendja të shkon që këta skifterë janë mbajtur nën fre nga

vetë organizatorët e protestës. Duke mos prodhuar skenarë sulmi me çdo kusht për të arritur tek dyert e jashtme të Kuvendit. Nëse kjo stinë protestash, e nisur me kaq paralajmërimë ogurzeza shtrihet dhe vijon në shtratit e natyrshëm të demonstrimeve jo të dhunshme, kemi arritur si vend atë që dukej misioni i pamundur në janar, për shembull, të kanalizojmë protestën e një opozite që ka bërë një akt të pashëmbullit në historinë 95 vjeçare të demokracive

evropiane, të vetëflijojë asetin më të çmuar që ka, të drejtën e përfaqësimit të qytetarëve që e kanë votuar në jetën normale politike të një vendi. Kjo e ka bërë parlamentin tonë të duket sot i panatyrshëm, madje jo-ekzistent. Zëvendësuesit e deputetëve të dorëhequr janë surrogat dhe xombi politike që gjithçka mund të duken, por jo përfaqësues të vullnetit të votuesve. Nuk ka opozitë në parlamentin tonë sot. Ajo është në rrugë. Ajo është opozita reale e vendit dhe e tillë do të mbetet, pavarësisht surrogatëve të dala nga procedura teknike zëvendësimi. Kjo opozitë reale duket se ka larguar dhunën nga tehu i armës së sotme politike të saj dhe ky është shërbimi më i madh që mund t'i bëjë ajo në këto momente qytetarëve të vendit të vet. Pavarësisht se duket sikur dhuna e saj është "e trembur" nga telat me gjemba, profesionalizmi dhe vendosmëria e policisë për të mbrojtur godinat kryesore të Shtetit. Nëse opozita do të vijojë t'i qëndrojë këtij shtegu jo-dhunë të aksionit të saj politik jashtë terrenit normal demokratik, me gjithë pasigurinë që kjo "lojë jashtë vijave kufizuese të fushës" prodhon, do të rikthehet të jetë një vlerë e patjetërsueshme e këtij vendi. Thjesht dhe vetëm me protestën paqësore. Sikurse kishite harruar të ishte prej vitesh, tashmë. Sigurisht, tundimi për të pranuar ose provokuar dhunën do jetë bashkudhëtar i saj. Por nëse opozita e mposht brenda vetes këtë tundim, do të ankorojë anijen e saj të batërditur në portin e vlerave, aty ku duam ta shohim të gjithë.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinioni *i* Ditës

# Pse Edi Rama nxitoi drejt RAI-t

## (Një reagim ndaj Europës së dy shpejtësive)

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... vendit po ia prishin protestat e opozitës. Ai u shfaq pak pas mesnatës në pjesën e tretë të "Porta a Porta", te Bruno Vespa, me një format që do ta kishin zili edhe emisionet më servile të Tiranës. Përballë pati një gazetar, Pietro Senaldi, që merakosej për prishjen e stabilitetit shqiptar, si pasojë e ndërhyrjes së fuqive antiperëndimore, mikun e tij Igli Tare, që i sjell falas carterin për të parë në stadium Kristiano Ronaldon dhe një investitor që merret me biznesin spitalor në Shqipëri, Mimmo Petrosillo.

Sikur për pak çaste aty të mos ishte shfaqur një intervistë me tone tejet kritike e Luzlim Bashës, e gjitha do të kishte lënë shijen e një propagande bajate, nga ato që qeveritë e vendeve të botës së tretë, i kontraktajnë me sektorët e marketingut të mediave të mëdha.

E gjitha ajo shfaqje e gërditshme, me siguri nuk u ka ndihmuar as italianëve, pjesa më e madhe e të cilëve në atë orë gjendeshin në gjumë dhe as shqiptarëve, që të tilla "mis en scene" i shohin me bollëk në ekranet e tyre.

Por, ajo i ka volitur një njeriu, Edi Ramës, që me sa duket me receptorët mjeshhtërisht të stërvitur prej propagandisti, e ka nuhatur mirë rrezikun që po i kanoset.

Që nga protesta e opozitës në 16 shkurt dhe më tej, pas vendimit radikal për djegjen e mandateve, Shqipëria është rikthyer në vëmendjen e Perëndimorëve. Natyrisht, duhet thënë hapur dhe qartë se nga kancelaritë euro-atlantike Edi Ramës nuk i ka hyrë asnjë gjemb në këmbë. Të gjithë pothuajse një zëri kanë dënuar aktet e dhunës dhe sjelljen ekstremiste të pakicës për të braktisur kuvendin. Në këtë aspekt, për pushtetin e rilindjes, situata duket ende rozë.

Por, një vëzhgues i vëmendshëm nuk mund të mos këyqerë një lëvizje tektonike që zhvillohet me sens të kundërt. Një mori mediash prestigjioze kanë rikthyer sytë nga Tirana. Sipas devizës së njohur të këtij profesioni, se lajm është vetëm lajmi i keq, ato po përpiqen të kuptojnë arsyt e asaj që po ndodh në Tiranë. Dhe "Rai 2" e dha verdiktin e tij: trafikantët e drogës që blejnë vota (poshtë).

Pas 16 shkurtit, francezja "Libération" ia atribuoi protestat, rrugës që po ngrihet kundër krim-it të organizuar dhe korrupsionit "France 24" vëzhgonte se rinia shqiptare e sheh veten jashtë vendit, ndërsa pothuajse të gjitha të përditshmet e përtej Adriatikut sollën korrespondentët e tyre në Tiranë.

Kush e njeh mirë dinamikën e krizave politike anembanë botës, nuk e ka të vështirë të kuptojë se zakonisht janë mediat aty që kanë të drejtë. Janë ato që kapin sinja-



let e para të asaj që po ndodh dhe të vërtetave që burokratët dhe diplomatët perëndimorë arrijnë t'i artikulojnë me shumë më tepër vonesë.

Kjo garë e dy shpejtësive, asaj të zyrtarëve teknokratë, të ambasadorëve lokalë, të njerëzve që vëgjetojnë në nivelet fundore të administratave perëndimore, që e kanë vështirë të shkëputen nga raportet që u kanë hartuar eprorëve prej viteve dhe nga politikat që kanë vultur pas diskutimesh të pafundme, kjo garë pra, mes tyre dhe një grupimi tjetër, atij të gazetarëve dhe reporterëve të terrenit, që perceptojnë realitetin e momentin dhe prekin të vërtetën faktike, është zhvilluar në më se një rast edhe në Shqipëri.

Ajo, ka treguar se të parët shpesh kanë qenë të gabuar dhe të vonuar dhe në fund kanë adaptuar qëndrimet dhe pasqyrimin që ka bërë media.

Le të sjellim vetëm një shembull nga periudha e qeverisjes së Rilindjes. Ndërkohë që ambasadori amerikan shpallte në krah të Saimir Tahirit, luftën kundër drogës si një histori suksesi, ndërkohë që Guardia di Finanza dekretoje në vjeshtën e 2016 kanabisin të çrrënjësor nga Shqipëria, ndërkohë që Rama krekosej në parlament se "po të kishte hashash, nuk mund të heshte Lu dhe Vlahutin", mediat dhe opozi-

ta filluan denoncimin e këtij fenomeni që po merrte përmasa marramendëse.

Nuk vonoi shumë dhe kjo betejë dhëmb për dhëmb, mes pushtetit që ironizonte kazanët gazetareskë dhe makinerinë politike të baltës dhe fakteve të përditshme të parcelave të kanabisit, tërhoqi vëmendjen e shtypit ndërkombëtar. Në pak muaj në Shqipëri nuk mbeti media prestigjioze pa shkelur dhe pa denoncuar hambarin e "barit" të Europës.

Vetëm pas kësaj, pas kthimit në një kauzë të brendshme, gazetat dhe TV perëndimore kthyen sytë nga Tirana dhe u desh denoncimi i tyre që të shkudne nga letargjia diplomatë e Tiranës dhe eprorët e tyre që mbulojnë Ballkanin.

Këto do të bënin që Donald Lu, t'i shkonte në zyrë Edi Ramës për t'i kërkuar shkarkimin e ministrit të Brendshëm dhe që europarlamentarët dhe Bundestagu gjerman të ngrinin zërin për luftën kundër kanabisit.

Në përmasa të tjera, kjo që po ndodh tani, mund të përsërisë të njëjtin skenar. Provokimi i një krize nga opozita, dhuna, djegia e mandateve dhe braktisja e parlamentit, kanë krijuar premisën për kthimin e syve nga Shqipëria. Mediat perëndimore tashmë ia kanë behur dhe po vënë gishtin

mbi plagë. Ndoshta nuk është e largët dita kur të vërtetat e tyre do të shkudnin nga përgjumja edhe diplomatët lokalë dhe kancelaritë e vendeve të tyre.

Pikërisht këtë lojë, atë të perëndimit të dy shpejtësive, ku gazetaret përshkruajnë një realitet që trondit më pas edhe burokratët, e ka kuptuar edhe Edi Rama. Si një njohës i mirë i "PR" ai e ka ndërjerë se ç'mund të prodhojë në të ardhmen mekanizmi mediatik i vënë në lëvizje.

Prandaj ai la parlamentin dhe nxitoi të nxjerrë kokën, pak pas mesnatës në "Porta a porta". Prandaj ai ka lobuar me gjithçka kishin mundësi që të balancojë valën e artikujve dhe reportazheve për qeverisjen e tij, që nuk po pushojnë në mediat perëndimore që prej 16 shkurtit.

Askush nuk mund të vërë bast se me sponsorizimin e shfaqjeve të neveritshme si ajo e së martës në mbrëmje, ai do të arrijë ta realizojë qëllimin e vet. Por, ama, asnjëri nuk mund ta akuzojë si miop, që nuk e shikon se nga i vjen rreziku.

Pavarësisht se për momentin e ka mbështetur e kancelarive, ai tashmë e di se cili është "kazoni" që mund të shkërmoqë fasadën e shndritshme që ka ndërtuar, duke nxitur një efekt domino. Për të ndaluar këtë, shkoi e ra në gjunjë tek Bruno Vespa.

### HOROSKOPI

#### DASHI

Tani për tani, reputacioni juaj mund të jetë shqetësimi juaj kryesor, por nuk mund të harrosh atë që është me të vërtetë e rëndësishme. Pa marrë parasysh se çfarë, ju nuk duhet të bëni diçka vetëm, sepse ju bën të dukeni mirë në sytë e të tjerëve.

#### DEMI

Një udhëim mjaft zbravës parashikohet të ndodhë për disa prej të tjerëve në shtetëri tuaj. Flori të planifikoni se si do të shpërndisni dhe gjatë kësaj udhëimi. Do të mund të shihni gjërat ngarëj perspektivës keq e re në këtë udhëim dhe do të flori një kuptim më të thellë për disa qëshije të rëndësishme.

#### BINJAKET

Përpjekja për të ndihmuar dikë të jetë më i lumtur është një ndërmarrje jashtëzakonisht e vështirë dhe një rrezik i madh. Ndonjëherë ju thjesht duhet t'i lejon njerëzit të jetojnë në mënyrën se si ata zgjedhin të jetojnë.

#### GAFORJA

Energjia juaj fizike do të lëkundet në mënyrë të paparashikueshme sot, por kjo nuk do të ndikojë negativisht në mprehtësinë tuaj mendore. Do të shihni diçka shumë interesante në zhvillim ndërsa njerëzit e tjerë nuk janë të vetëdijshëm për këtë.

#### LUANI

Do të bëhet jashtëzakonisht e lehtë të merrni me sjelljen intuese të disa njerëzve sot, sapo të kuptoni se kjo është e gjitha një lojë dhe disa njerëz nuk janë aq të mirë për të luajtur atë. Arroganca e tyre nuk është një shenjë se ata e dinë se për çfarë po flasin - përkundrazi!

#### VIRGJERESHA

Dikush pranë jush po përballon me konfuzion. Ju mund të dëshironi të ndihmoni në zgjidhjen e dilemës së këtij personi, por kontributi juaj mund të shihet si diçka kritike në vend të konstruktivitetit, sado i ndjeshëm që përpigëni të jeni.

#### PESHORJA

Prania e dikujt që do të shfaqet papritur në një aktivitet në grup mund të bëjë që të gjithë të ndihen të cuditshëm në fillim, por ju duhet të mësoheni me këtë. Të qenit mikpritës do të krijojë shumë më tepër harmoni në jetën tuaj.

#### AKREPI

Sot, mënyra se si komunikoni me njerëzit e tjerë do të dëshmojë se sa përparim keni bërë në departamentin e ruajtjes së qetësisë. Do t'ju duhet të mbani gojën, kur dikush të përpigë t'ju shkaktojë nervozizëm.

#### SHIGJETARI

Kënaquni më shumë me muzikën dhe me artin sot. Arti vizual do të stimulojë edhe mendjen tuaj, kështu që bëni ndonjë vizitë në një muze apo në një galeri arti. Edhe udhëtimet do t'ju bëjnë që të ndihen mjaft mirë.

#### BRICJAPI

Mënyra se si do ta trajtoni një konflikt do të jetë një arritje e madhe. Duket sikur më në fund do të mësoni të qëndroni me këmbë në tokë. Në çështjet e dashurisë, do të keni nevojë për një nxitje të re.

#### UJORI

Energjia juaj mendore dhe energjia juaj fizike nuk janë në sinkronizim sot, dhe do t'ju duhet të përshatëni që të ruani sa më shumë harmoni. Fatmirësisht, shumë njerëz të afërt me ju jpin janë gati të qetësojnë gjendjen tuaj ose t'ju japin një nxitje energjike kur keni nevojë për të.

#### PESHQIT

Bashkëpunëtorët tuaj më të dobishëm janë në një humor jashtëzakonisht të dobishëm kohë e fundit. Në jetën tuaj personale, do të jesh ai që ndien nevojën për të ndihmuar njerëzit. Një mik mund të ketë nevojë për ndihmë në një ditë veçanërisht me tensione.

VENDIMI

Arbitrat bojkotojnë kaampionatin. Njëpërmet një deklaratë për shtyp, Shoqata Bashkimi i Arbitrave të Futbollit Shqiptar njofton se ka vendosur të bojkotojë ndeshjet e futbollit në nivel kombëtare deri në momentin që të ndihen të sigurt dhe Policia e Shtetit të kthehet në stadium. Kjo është masa ekstreme e

marrë nga "bilbilat" shqiptarë, pas "ping pongut" institucional me deklarata për shtyp mes FSHF dhe Policisë së Shtetit. "Shoqata Bashkimi i Arbitrave të Futbollit Shqiptar, e tronditur pas ngjarjes së dhunës ekstreme ushtruar ndaj gjyqtarit Eldorjan Hamiti në Kamëz, ka marrë sot vendimin e saj për të bojkotuar ndeshjet e futbollit në nivel ko-

Ndalet kampionati, arbitrat bojkotojnë garat

mbëtar. Duke parë që nga java e parë e kampionatit dhe deri në të fundit ne ndjehemi të pasigurt, sot ne vendosëm të themi: Mjaft! Mjaft më me kërcënime, fyerje e sharje. Mjaft dhe kjo është shumë më serioze dhe e rrezikshme) me dhunë e ç'është

më e rëndësishmja, mjaft më me pasiguri për jetën. Njëzëri arbitrat mendojnë se eksperimenti i deritanishëm për largimin e Policisë së Shtetit nga stadiumet e futbollit ka dështuar. Zëvendësimi i tyre me polici private është një dështim tjetër tashmë

i konsumuar. Ashtu siç nuk kemi se ç'të presim më edhe nga eksperimenti tjetër i zbatimit të ligjit, i cili ka dështuar plotësisht, përdërisa autorët e dhunës janë liruar sot, edhe se pamjet filmike janë shumë të qarta dhe media ka katër ditë që e ka në qendër të vëmendjes këtë ngjarje. U kërkojmë klubeve anëtare në FSHF të na mirëkuptojnë dhe të na mbështes-

in në vendimin që ne kemi marrë, kjo sepse vendimi që ne kemi marrë është e vetmja rrugë që gara të jetë sa më e vërtetë dhe korrekte. Mjaft u eksperimentu. Ne kemi vendosur të mos luajmë me jetën tonë. Kështu nuk do të kthehemi për të gjykar, deri sa të ndjehemi të sigurt dhe Policia e Shtetit të kthehet në stadiume dhe autorët e dhunës të ndëshkohen."

Dënim dhe për zyrtarët, tre vjet pezullim për presidentin Qarri dhe drejtorin Matraxhiu



Jeton Selimi

# Disiplina zhduk Kamzën nga harta e futbollit!

Përrjashtohet nga gara dhe zbret dy kategori më poshtë

Komisioni i Disiplinës në Federatën Shqiptare të Futbollit "masakron" klubin e Kamzës. Ashtu siç edhe pritej, Kamza është përjashtuar nga ky kampionat i Kategorisë Superiore madje sezonin e ardhshëm do të nisë gjithçka nga Kategoria e Dytë, pra dy kategori më poshtë. Dhuna ndaj arbitrit Eldorjan Hamiti në ndeshjen ndaj Laçit, i ka kushtuar rëndë jo vetëm klubit nga periferia e kryeqytetit, por edhe presidentit të Kamzës, Naim Qarri, i cili ka marrë një pezullim shembullor nga aktivitetet futbollistike ashtu si edhe disa drejtues të tjerë të Kamzës. Ja vendimet e plota të Disiplinës.

"FK "Kamza", për dështim në përmbyshjen e përgjegjësiëve për organizimin e ndeshjeve, duke mos zbatuar rregullat e sigurisë, duke mos garantuar sigurinë e zyrtarëve të ndeshjes dhe zbatimin e ligjit, në bazë të nenit 64/1/b, 64/1/c), 64/1/e), 65/1 dhe 65/2 të KDS, dënohet me përjashtimin nga çdo aktivitet futbollistik për sezonin 2018-2019 si dhe gjobë në masën 1.000.000 (një milion) lek. Në bazë të nenit 29 të KDS, FK "Kamza", dënohet me zbritjen në Kampionatin Kombëtar të Futbollit të Kategorisë së Dytë duke filluar nga sezoni futbollistik 2019-2020.

Zyrtari i FK "Kamza", Naim Qarri, për dhunë ndaj zyrtarit të ndeshjes duke e goditur me grusht, në bazë të nenit 49/2/b) dhe 49/3 të KDS, dënohet me 36 (tridhjetë) muaj pezullim nga çdo aktivitet futbollistik si dhe gjobë në masën 100.000 (njëqindmijë) lek. Në bazë të nenit 20 dhe 21 të KDS, zyrtarit i ndalohet hyrja në të gjitha stadiumet e Republikës së Shqipërisë si dhe hyrja në dhomat e zhvëshjes dhe territoret përreth fushave të lojës apo stolat e rezervave.

Zyrtari i FK "Kamza", Andi Matraxhiu për sjellje të gabuar ndaj zyrtarit të ndeshjes në mënyrë të

përsëritur dhe nxitje të urrejtes e akteve të dhunës, në bazë të nenit 49/2/b) dhe 52 të KDS, dënohet me 36 (tridhjetë) e gjashtë) muaj pezullim nga çdo aktivitet futbollistik si dhe gjobë në masën 100.000 (njëqindmijë) lek. Në bazë të nenit 20 dhe 21 të KDS, zyrtarit i ndalohet hyrja në të gjitha stadiumet e Republikës së Shqipërisë si dhe hyrja në dhomat e zhvëshjes dhe territoret përreth fushave të lojës apo stolat e rezervave.

Zyrtari i FK "Kamza", Albert Bana, për sjellje të gabuar ndaj zyrtarit të ndeshjes, në bazë të nenit 49/2/b) dhe 49/3 të KDS, dënohet me 18 (tetëmbëdhjetë) muaj pezullim nga çdo aktivitet futbollistik si dhe gjobë në masën 100.000 (njëqindmijë) lek. Në bazë të nenit 20 dhe 21 të KDS, zyrtarit i ndalohet hyrja në të gjitha stadiumet e Republikës së Shqipërisë si dhe hyrja në dhomat e zhvëshjes dhe

territoret përreth fushave të lojës apo stolat e rezervave".

DËNOHET DHE DERBI

Por edhe klubet e tjera të



superiores kanë kaluar në sitën e Komisionit të Disiplinës për çështje të ndryshme. Kështu edhe derbi i madh i kryeqytetit ka pasur dëmet e tij anësore. Pavarësisht spektaklit në tribuna, sikundër ndodh në çdo përballje, Tirana dhe Partizani do të vuajnë pasojat. Më rëndë e ka pësuar Tirana, e cila do të jetë e detyruar të luajë pa tifozë përballjen e javës së 27-të, kur do të presë Laçin. Ultrasit bardheblu u bënë shkak për ndërprejen disaminutëshe të derbit për shkak të hedhjes së flakadanëve në fushë, ndaj dhe disiplina ka mbyllur dyert e "Selman Stërmasit" për një sfidë. Ndërkohë Partizani është gjobitur me 300 mijë lekë të rinj për sjelljen e gabuar të tifozëve, që gjatë derbit ndezën flakadanë në tribuna, por pa cenuar mbarëvajtjen e garës.

Kukësi "fërkon" duart, mund të rikuperojë dëmtimet

Ka ardhur si një dhu Krratë nga qielli për Kukësin vendimi i Shoqatës së Arbitrave, që dje zyrtarizuan bojkotin e kampionatit derisa të plotësohen kushtet e nevojshme që atyre t'u garantohet jeta. Dhe kuptohet, që me atë që ndodhi në Kamëz, gjyqtarët kanë të gjithë të drejtën e botës të ngrenë zërin për moscenimin e tyre fizik dhe moral. Verillindorët kanë një listë të gjatë me lojtarësh të dëmtuar dhe të tjerë që nuk janë të në 100% të formës së tyre. Kështu dy sfidat e radhës, atë ndaj Skënderbeut në Korçë dhe duelin titull me Partizanin, e kishin të humbur Cuculi, Kordeiro dhe Rrumbullaku, ndërsa Shameti, Rexhinaldo dhe Shkurtaç nuk ishin në 100% të tyre. Por tashmë situata ka ndryshuar dhe, pas këtij vendimi të gjyqtarëve për të mos zbritur në fushën e lojës javën e ardhshme, drejtuesit e Kukësit shpresojnë të rikuperojnë të gjithë të dëmtuarit për dy ndeshjet e zjarrta ndaj Skënderbeut e Partizanit.

Ndërkohë Skënderbeu shkon në gjysmëfinale të Kupës

Përrjashtimi i Kamzës, rivalët fitojnë ndeshjet e mbetura në tavolinë

Rregulli është i qartë, nëse një skuadër përjashtohet nga gara kur janë zhvilluar 50% plus një ndeshje, pra më shumë se gjysma e garës, të gjitha sfidat e mbetura shkojnë 3-0 në tavolinë për skuadrat e tjera. Kjo vlen dhe për rastin e Kamzës, që pak orë më parë u ndëshkua me zbritje dy kategori më poshtë nga Komisioni i Disiplinës në FSHF për shkak të dhunës ndaj gjyqtarit Eldorjan Hamiti. Me 12 ndeshjet e mbetura për t'u zhvilluar, të gjitha ekipet në kampionat do të përfitojnë një fitore 3-0, ndërsa përjashtim bëjnë Luftëtari, Flamurtari e Skënderbeu, që kanë për të zhvilluar sfidat e kësaj faze me Kamën si dhe ato të fazës së fundit, ndaj do të përfitojnë 6 pikë, ndryshe nga skuadrat e tjera. Kalendari do të zbatohet siç është, nuk do të ketë asnjë ndryshim, ndërsa skuadrat që do të luajnë sfidën e tyre ndaj Kamzës, atë javë do të qëndrojnë pushim. Ndërkohë tjetër lajm i mirë dhe për Skënderbeun, që ka kaluar automatikisht në gjysmëfinalen e Kupës së Shqipërisë!


25 lojtarë dalin në rrugë

Lojtarët e Kamzës shpërthejnë në lot

Ka qenë një pasdite e trishtë ajo për lojtarët e skuadrës së Kamzës, të cilët lajmën përjashtimit të klubit të tyre nga Kategoria Superiore e kanë marrë në momentin kur po kryenin seancën e radhës stërvitore. Në sytë e lojtarëve nuk kanë munguar lotët, në një kohë që 25 lojtarë dalin menjëherë në rrugë dhe në pamundësi për t'iu bashkuar ndonjëskuadre tjetër brenda kampionatit. Shansi i vetëm janë ligat aziatike apo nordike, që startojnë edicionin në mars, por nga gjithë skuadrat e Kamzës, jo të gjithë lojtarët mund ta kenë këtë fat. Seanca stërvitore u la përgjysmë, askush nuk mund të përqëndrohej më në këto kushte kur kanë mësuar dënimin e dhënë, një dënim që nuk ka asnjë lidhje me lojtarët, që në fushën e lojës kanë qenë më se korrekte.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Një pije freskuese.
- Graf ish teniste.
- Dada, ish-diktator i Ugandës.
- Eshtë pasuri e investuar.
- Mund të jenë fetare.
- Një pjesë e relacionit.
- Fillojnë ambalazhimin.
- Një vegël.
- Qe harkëtar i famshëm i akejve.
- Fillojnë hetimin.
- Një atentator vëtvërasës.
- Kështu janë takimet zyrtare.
- Eshtë anije me dy skafe.
- Fundi i Turandot.
- Inicialet e Reitman regjisor.
- Farrell regjisor.
- Schneider që qe aktore.
- Mund të jetë e lirë për hartim.
- Emri i Pasternak.
- Ekberg e La dolce vita.

- Makina Uno.
- Eshtë shpend lagune.
- Eshtë operator që bën zoom.
- Eshtë i pashpirt.
- Parashtesë për një.
- Pak enigmatike
- Një pjesë e Toskërisë.
- Agustini ish-bomber.
- Kufizojnë një princip.
- Miku i Batman.
- Tapeti për judo.
- Janë stadet në videogame.
- Bëhet një kundër vendimit.
- Janë me blerim mbuluar në një film
- Eshtë shtet aziatik.
- Papavrami violinist
- Fadili komik
- Përhëndetja e Jul Qezarit.
- Mbyllin fushatat.
- Me të bëjnë një ketër.
- Mbyllin një takimin.

- Dikur quhej Mediolanum.
- Ruajnë pa ujë.
- Një mund të jetë kalendarik.
- Një është meskini, shpirtngushti.
- Një hidrokarbur.
- Mund të jetë franceskan.

**VERTIKAL**

- Jessica Parker aktore.
- Zola shkrimtar.
- Janë dritë të tilla me parsec.
- Mund të jenë gjaku.
- United Kingdom.
- Eshtë njeri me principe.
- Një polimer për kirurgji estetike.
- Kufizojnë takimet.
- Diftong teatral.
- Fillojnë fluturimin.

**Fjalëkryqi (2)**


**HORIZONTAL**

- Një pemë gjigante.
- Janë për të kërcyer.
- Ishtë shkolla e Aristotelit
- Një thirrje me emra.
- Gjysmë rivale.
- Një pjesë e narkotikëve.
- Një tis... mjegulle
- E famshme ajo e Keopsit
- Mbyllin një sirtar
- Eshtë ngjyrë e... fytyrës.
- Fillojnë lejen.
- Janë aktorë kryesorë.
- Janë kompozime të kënduara.
- Hudson aktore.
- Satelit i Uranit.
- Fillojnë tatëpjepën.
- Mbetur në fund.
- Sapo fillojnë.
- Kastile janë në fund.
- Kufij takimi.


- Ekstremet e tokës.
- Inicialet e Einstein.
- Qendër mësimi.
- Kështu thirrej Marco Pantani.
- Pak irredentizëm
- Fundi i një filmi.
- Popullojnë qytetin.
- Janë gojë vullkanesh
- Eshtë edhe ai Persik.

**VERTIKAL**


- Mund të jetë sekrete në derë.
- Makina Agila.
- Ami i Maupassant.
- Mbyllin një sirtar.
- Rrëzohen me strike
- Luciano tenor i paharuar.
- Mbyllin këndet
- Eshtë borxh.
- Mbyllin portat.
- Hagen rockstar.
- Një pjesë e akademisë.
- Bien me ballë.
- Një barkë lëkurëkuqsh.
- Atje ku shkon progresisti
- Pallati i Dalaj Lamas në Lhasa
- Një pjesë e minoritetit.
- Eshtë fluturues në ufo.
- Do të bëhen mace të tilla.
- Fletë pa kufij.
- I ka tek rendi.
- Kreshniku i volejbolit.
- Një det që është liqen në fakt.
- As unë, as ai.
- Në mes të King edhe Cole të muzikës.
- Një parashtesë zmadhuese.
- Eshtë lon papagalli.
- Titulli i Sean Connery.
- Fillojnë panikun.
- Gjysma e rojave.
- Fitim pa kufij.
- Mbyllin një sherr.
- Fillojnë një metodë.
- Kufizojnë botimet.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

			4					8
				3				
5		7		1				
	2		1		6	3		
							7	
	3		5				4	
		4		5				6
	1							
			6		8		2	1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

3	4	8	6	2	9	1	5	7
9	5	6	1	7	8	2	3	4
2	1	7	3	4	5	6	8	9
4	6	1	2	5	3	9	7	8
5	8	2	7	9	4	3	1	6
7	9	3	8	1	6	4	2	5
8	2	4	9	3	7	5	6	1
1	7	5	4	6	2	8	9	3
6	3	9	5	8	1	7	4	2

*Argëtim filozofik*

- Por do të vijë çasti kur vetmia do të të lodhë, kur krenaria jote do të përketul dhe guximi yt do të dërmohet. Atëherë do të bërtasësh "Jam vetëm".

- Gjërat më të bukura në jetë nuk i shohim me sy ... por i ndjejmë me zemër !!!

- Përpjekja për të sjellë parajsën në tokë, udhëheq pa përgjithim, në ferr.

- Kënaqësia më e madhe në natyrë, është mungesa e njerëzve.

\*- Kur ju mendoni atë që keni humbur, ju humbi atë që jetoni.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

8	A	11	16		7	5	15	8		3	8
1	Z	8	13	8	6		6	8		4	3
2	I	7		10	8	9	2		15	2	11
9	L		14	8	12	17	12	3	7	9	9
		5	7	15	5	8	5	2	16	8	5
4	8	6	5	2	15	8		7	15		10
7	5	7		12	7	15		6	11	6	5
5	6	4	7		5	2	18	2		11	19
5	4	11	6	19			9	8		4	8
9	11	15		1	7	5	8		19	8	1
7	6	2	14		14	7		16	11	15	7
5	7	8	4		8	9	3	8	15	7	5

S	A	F	O	M	A	M	L	A	F
A	N	A	K	O	S	T	U	M	E
R	K	A	K	T	O	R	I	A	L
A	L	K	L	E	O	P	A	T	R
F	U	K	I	T	R	E	T	I	S
L	A	N	G	E	K	I	B	F	K
B	U	R	G	U	A	A	A	R	I
A	T	A	L	N	U	R	A	T	A
S	K	E	D	A	R	E	A	A	O
M	I	L	A	O	M	E	B	U	R
A	N	A	L	I	T	I	K	E	L
T	A	T	E	A	K	T	O	R	I

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

M	A	T	T	G	A	S	T	T	N	T
A	C	H	A	B	S	H	I	K	U	E
L	E	B	I	P	T	R	A	N	S	I
I	D	E	M	O	K	R	A	T	I	K
P	A	L	E	S	T	I	N	E	Z	E
M	A	N	A	S	T	I	R	E	O	R
A	G	I	A	E	I	S	N	S	J	
T	A	R	T	A	R	I	O	T	S	J
E	N	T	E	E	U	R	E	K	A	V
R	E	A	L	E	R	E	P	A	R	T
I	T	A	T	O	T	E	S	T	E	T
A	A	T	L	A	S	T	E	R	I	C
M	I	C	K	U	A	S	K	I	L	E
I	L	R	T	R	O	M	A	N	E	T
T	K	E	R	M	A	N	E	L	I	N
B	A	N	A	N	E	T	M	A	D	E
T	E	P	A	R	E	T	A	S	A	I
H	A	R	E	L	A	N	P	L	I	
M	A	K	E	T	I	A	L	I	E	N
O	R	E	T	E	G	A	K	A	P	O
T	E	N	D	O	R	M	E	T	E	O
R	E	N	D	O	R	M	E	T	E	O
A	H	O	T	E	L	E	T	R	I	S
T	T	M	O	T	E	T	A	M	A	

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

*Thënie të mençura*

- Ta zemë se ajo më do, sa shumë do të më merzisë në këtë rast. Dhe, ta zemë se nuk më do, sa shumë arsye më të mëdha akoma do të kishte në këtë rast që ajo të më bëhet e mërzitshme! -
- Pra, nuk paska veçse dy mënyra për t'u mërzitur: kështu që, le të martohemi.

- Një mik gjatë gjithë jetës është mjaft, dy janë shumë, tre pothuajse është e pamundur.
- Kur interesohesh, nuk harron... kur kujdesesh, nuk i kthen shpinën mbrrapa, kur do...nuk kërkon kohë ... kur dashuron nuk lëndon!!!

